



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 107, shtator 2012

Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

DOM PREK NDREVASHAJ NË SHKODËR

Me datën 8 shtator 2012, nën kujdesin e famullisë së Shen Shtjefnit, të kisha e Motrave Stigmatine, në Gjuhador "Ndreke Guri u prezantua me librin "Dom Prek Vashaj", biografik.

NJË NDARJE E DHIMBSHME DHE E PARAKOHSHME



Me hidhërim të thellë i japim lamtumirën e fundit njeriut të dashur e të paharruar të familjes e të farefisit, shokut, mikut e kolegut tonë të nderuar, Dr. Prelë Gjeshit.

NJË DINASTI ARTISTËSH ...

Jemi komshi të hershem me familjen Smaja. Një familje e njohur në Shkodër. Familje e vjetër shkodrane, e fisme, e urte dhe e ndershme. Nga ato familjet që vegjetojnë urtësi dhe devocion. Nga ata familje që nuk vrapojnë duke kërkuar privilegje dhe mirënjohje. Por ëshë ajo, mirënjohja që vrapon, madje edhe lavdia...



DEKRET

Prot. Nr. 96/2012

VENËDIM I KRERËVE TË DUKAGJINIT I VITIT 1937

Mbledhja filloi nën kryesinë e të deleguesit të shkëlqesisë së tij Ipeshkvit të Dukagjinit Benardin Shllaku, Padër Rrok Gurashi, Zv.Nënprofektit Kapiten Z.Shaban Elezi:tuj pranue si sekretar Z.Asim Bekasin:

- Mas një diskutimi të gjatë mbledhja unanimisht pranoi e vendosi pikat e poshtshueme: 1- **Festat me miq** janë krejt të ndalueme në çdo fshat e krahine me përjashtim të bijave që vinë me fëmijë dhe atyret që kanë pasur një nevojë të domosdoshme dhe kjo e vertetueme me dëshminë e pleqnisë me shkrim dhe të jetë... dhe prej Postë Komandës së Vëndit.

FILLOI KURSI I GJUHËS SHQIPE NË VARESA-MILANO

Fëmijët e emigranteve shqiptare që banojnë në provincën e Varese të Italisë, fale iniciativës së sipërmarrësit Dukagjinas, nga Fshati i Planit të komunes Pult, Gjon Shtylleza, të mbështetjes dhe bashkëpunimit vullnetar të shoqatës "L'Orizont" dhe mbështetjes së shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" u bë e mundur fillimi i mësimit në gjuhën shqipe, ditën e shtune, me 22 shtator 2012, në mjediset e shoqatës "L'Orizonte". Fëmijët shqiptare në këto mjedise do të kenë çdo të shtune sallën e tyre për vazhdimin e mësimit. Mësuesja, Mereme Stafa me përvojë të gjatë në fushën e mësimit.

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:
GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh **Kimay**
PRODUCTION Produzione Giacche



DEKRET

Prot. Nr. 96/2012

Vrasjet e shumta që vazhdojnë të ndodhin në territorin e Dioqezave tona dhe jo vetëm aty, shumë prej të cilave për gjakmarrje, vënë në dukje se ka persona që nuk e zbatojnë urdhrin e Hyjit: "Mos vra", madje e shkelin atë haptazi, megjithëse e quajnë veten "katolikë të mirë". Disa vrasin nganjëherë pa asnjë ngurrim ose hakmerren në mënyrë të përgjakshme e barbare. Ata shpesh vetëarsyetohen, duke u mbështetur në një traditë shekullore, duke thënë se zbatojnë Kanunin. Ata i japin shumë rëndësi traditës së njerëzve se sa ligjit të Hyjit. Të gjithë ata që vrasin, me sjelljen e tyre, janë duke i vënë shqelmin Ungjillit të Jetës dhe Kryqit të Zotit tonë Jezu Krishtit. Sjellja e tyre pra është një fyerje ndaj Krishtit, i cili ka zgjedhur 'ta japë' gjakun e Tij për shëlbimin e njerëzimit dhe jo 'ta marrë' atë si 'shpërblim' për mëkatet dhe fajet që ne bëjmë.

Meqenëse e ndiejmë thellë përgjegjësinë tonë si Barinj të Kishës që është në Shkodër, në Sapë e në Lezhë dhe na duhet t'i mbrojmë bashkësitë e krishtera nga çfarëdo rreziku, pasi jemi këshilluar me bashkëpunëtorë dhe ekspertë si dhe me ata që kanë rënë drejtpërdrejt në kontakt me këto episode, me qëllim që të arrihet pendimi i vrasësve dhe zbutja e zemrave të të gjithë njerëzve në mënyrë që ngjarje të tilla të mos ndodhin më,

DEKRETOJMË

Se kushdo që bën një vrasje ose bashkëpunon që ajo të bëhet ose ndihmon në mënyrë të qëllimshme që ajo të ndodhë, në bazë të nenit 1331 të Kodit të së Drejtës Kanonike ndëshkohet me shkishërim (dmth. ekskomunikim).

Prandaj, në bazë të të njëjtit neni 1331

DEKLAROJMË se i shkishëruari:

1. Nuk mund të marrë pjesë në kremtimet e Kishës

2. Nuk mund të marrë Sakramentet (rrëfimin, kungimin, krezmimin, kurorën e shenjtë, urdhrin e shenjtë)


3. Nuk mund të marrë sakramentoret, si funeralin dhe varrim-

in e krishterë në varrezat katolike. Në bazë të nenit 1335 kujtojmë se: "Nëse ndëshkimi ndalon kremtimin e sakramenteve..., ndalesa pezullohet nëse kjo është e nevojshme për t'u kujdesur për besimtarët që gjenden në rrezik vdekjeje".

Dera e Kishës do të jetë gjithmonë e hapur për ata që, të goditur nga ky dekret dhe nga

4. Të marrin faljen nëpërmjet rrëfimit sakramental.

Dispozitat e lartpërmendura hyjnë në fuqi prej ditës së dielë më 16 shtator 2012, kur kjo letër do të lexohet në të gjitha kishat e Dioqezave tona. Ato diktohen prej kujdesit atëror për mbrojtjen e popullit të Hyjit (krh. nenin 1742 të KDK).



ndëshkimet e parapara prej tij, pendohen dhe, duke e ndryshuar mendësinë e tyre të vrasjes, duan të kthehen në bashkim të plotë me Hyjin dhe me Kishën. Ata duhet ta shfaqin konkretisht qëllimin e tyre real për ndryshim duke zbatuar kushtet që vijojnë:

1. Ta shfaqin publikisht pendimin e tyre,

2. Ta ndreqin padrejtësinë e bërë,

3. Ta kryejnë dënimin e paraparë prej ligjit,

Shkodër, prej Kuries Arqipeshkore Metropolitane, më 14 shtator 2012, Festa e Lartësimi të Kryqit.

X Lucjan Avgustini X Angelo Massafra OFM X Ottavio Vitale RCJ

Ipeshkëvi i Sapës Arqipeshkëvi i Shkodër-Pult Ipeshkëvi i Lezhës

Dom Robert Kola Kancelar, Atë Artan Seli SDS Kancelar, Atë Flavio Cavallini OFM Kancelar

PROT. NR. 96A/2012

SHKODËR, 14/09/2012

Shumë të dashur besimtarë të Arkidioqezës së Shkodër-Pult, të Dioqezës së Sapës dhe të Dioqezës së Lezhës!

Zoti ju dhashtë paqe!

Me këtë letër po jua hapim zemrën tonë të plagosur dhe bashkëndajmë me ju shqetësimin e madh dhe dhimbjen atërore që na kanë nxitur të shpallim dekretin për ndëshkimet kanonike të parapara në rast vrasjeje. Jemi me të vërtetë shumë të shqetësuar për numrin e madh të vrasjeve dhe të akteve kriminale që janë duke ndodhur në këtë vit 2012. Si të mos na vijë keq kur shohim se kaq shumë (njerëz), bij të Hyjit dhe të dashur prej Zotit, e humbasin jetën për shkak të vendimit vrasës të dikujt tjetër? Si të mos ndiejmë dhimbje edhe për faktin se disa bij të Hyjit, të dashur edhe ata prej Zotit, bëhen vrasës, duke bërë një krim që rëndon në ndërgjegjen e tyre dhe vë në rrezik shëlbimin e tyre të amshuar? Këtë vit shqetësimi ynë është rritur ditë pas dite, duke dëgjuar meshtarët që na vijnë në dijeni për faktin se po shtohen gjithnjë e më shumë dhuna në familje, përdorimi i forcës në marrëdhëniet mes personave dhe "logjika" e hakmarrjes dhe e "gjakmarrjes". U jemi mirënjohës meshtarëve për punën baritore që kryejnë në bashkësitë e krishtera për të shpallur Ungjillin e Jezu Krishtit dhe për të nxitur një mendësi që është gjithnjë e më besnike ndaj Hyjit dhe ndaj ligjit të Tij të dashurisë. Në të njëjtën kohë, të gjithë jemi të vetëdijshëm se edhe mes atyre që janë pagëzuar disa nuk e respektojnë jetën e të tjerëve, duke mos jetuar kështu personalisht një jetë të krishterë siç na ka mësuar Shëlbuesi ynë Jezu Krishti.

Të gjithë e njohim mirë urdhrin e pestë të Zotit, që thotë: "Mos vra". Dhe neni 2268 i Katekizmit të Kishës Katolike thotë qartë: "... Vrasësi dhe ata që lirisht bashkëpunojnë në vrasje bëjnë një mëkat që kërkon hakmarrje prej qiellit (Zan 4,10)". Mjerisht ka njerëz që nuk e zbatojnë urdhrin e Hyjit, madje e shkelin atë haptazi, megjithëse e quajnë veten "katolikë të mirë". Disa madje vrasin nganjëherë pa asnjë ngurrim ose hakmerren në mënyrë të përgjakshme e barbare. Ata shpesh vetëarsyetohen duke thënë se zbatojnë Kanunin. Duke u mbështetur në një traditë shekullore dhe duke i dhënë më shumë rëndësi traditës së njerëzve se sa

ligjit të Hyjit, mendojnë se marrja e gjakut është një detyrë dhe, duke menduar kështu se bëjnë drejtësi, nuk i japin rëndësinë e duhur të keqes që bëjnë. Në të vërtetë vrasja për gjakmarrje ka të njëjtën peshë si çfarëdo vrasjeje tjetër, madje, do të thoshim edhe më të madhe, sepse paramendohet dhe përgatitet në çdo hollësi nganjëherë për vite të tëra. Edhe më keq, të gjithë ata që vrasin, me sjelljen e tyre vrasëse i vënë shqelmin Ungjillit të Jetës dhe Kryqit të Zotit tonë Jezu Krishtit që ndoshta e mbajnë në qafë ose e kanë të varur në muret e shtëpive të tyre! Sjellja e tyre pra është një fyerje ndaj Krishtit, i cili ka zgjedhur 'ta japë' gjakun e Tij për shëlbimin e njerëzimit dhe jo 'ta marrë' si 'shpërblim' për mëkatet dhe fajet që ne bëjmë. Sjellja e tyre, nëse e mendojmë mirë, është pra një fyerje ndaj Gjakut të Krishtit.

Nëse jemi me të vërtetë të krishterë dhe katolikë, Ungjilli dhe vlerat që burojnë prej fesë duhet ta ndryshojnë jetën tonë dhe mendësinë tonë, duhet të na bëjnë ta respektojmë jetën, që është e shenjtë dhe e paprekshme, që prej momentit të ngjizjes deri në vdekjen natyrore. Njëri prej aspekteve që duhet të ndryshojë patjetër në mendësinë tonë është ai i vënies së drejtësisë me duart tona dhe me armë, duke e vrarë tjetrin për çfarëdo konflikti, nganjëherë edhe i rastësishëm. Një element i rëndësishëm që ndihmon për këtë ndryshim të domosdoshëm të mendësisë jepet edhe prej faktit që shtetasit të munden me të vërtetë të kenë besim se Gjykata i ndëshkon fajtorët për krime dhe pra se mund të kenë besim se Organet Gjyqësore të Shtetit janë të drejta dhe të ndershme në gjykime, duke e shmangur korrupsionin.

U bëjmë thirrje këtyre Organeve Gjyqësore Shtetërore duke kërkuar rreptësinë më të madhe dhe asnjë zbritje dënimi apo lehtësim për vrasjet, dhe në veçanti për vrasjet "për gjakmarrje". Pra, kërkojmë maksimumin e dënimit, deri në dënimin me burgim të përjetshëm, për krimet e vrasjes, duke ia besuar vrasësin mëshirës së Hyjit, që të pendohet dhe të përpigjet të japë dëmshpërblim për krimin e bërë, edhe ndaj njerëzve të pafajshëm të familjes së viktimave që vuajnë pasojat e rënda të krimit (p. sh. gruaja e mbetur e vejë, bijtë e mbetur

jetimë!). Në numrin 2266 Katekizmi i Kishës Katolike thekson me të drejtë se mbrojtja e të mirës së përbashkët, pra e të gjithë shoqërisë, kërkon që Shteti të përpiqet për ta “frenuar përhapjen e sjelljeve cenuese të të drejtave të njeriut dhe të rregullave themelore të bashkëjetesës civile”. Prandaj është e nevojshme që ata që u shkaktojnë dëme të rënda të tjerëve të bëhen të padëmshëm.

Në këta vjet të episkopatit tonë jemi munduar të mos i humbasim rastet e ndryshme të takimit dhe të krenimit me ju në famullitë tuaj për t’u kujtuar të gjithëve atë që thotë Jezusi: “Kush më do, t’i mbajë urdhërimet” (...) dhe “prej kësaj do t’ju njohin se jeni nxënësit e mi, nëse e doni njëri-tjetrin” (Gjn 13,35).

Sa herë ju kemi folur për faljen që duhet

t’i kërkojmë Hyjit, por edhe për faljen që duhet t’u kërkojmë e t’u japim të tjerëve dhe ju kemi ftuar në falje e në pajtim! Sa herë e kemi përsëritur parimin: “shqiptari ta ndihmojë vëllain e vet shqiptar dhe të jetë i mëshirshëm me vëllain e vet shqiptar!”, si zbatim konkret i Ungjillit!

Arsyet që kemi shprehur në fillim të kësaj letre na kanë bindur se nuk janë më të mjaftueshme këshillat e porositë, sepse shpesh mbeten të padëgjua dhe njerëzit vazhdojnë të veprojnë në kokë të vet, duke e shkelur nganjëherë rëndë ligjin e Hyjit. Pra, mendojmë se ka ardhur momenti të përdorim ndëshkimet dhe dënimet që parasheh Kisha e Shenjtë dhe e Drejta Kanonike për krimet e rënda. Katekizmi i Kishës Katolike në numrin 2266 na kujton se “mësimi tradicional i Kishës e ka njo-

hur si të vlefshme të drejtën dhe detyrën për të dhënë ndëshkime në përpjesëtim me peshën e krimet”. Dhe vazhdon duke paraqitur se cili është qëllimi dhe vlera e ndëshkimit: “Ndëshkimi ka si qëllim të parë që ta ndreqë çrregullimin e sjelljeve prej fajit... ndëshkimi ka vlerën e shpërblimit... ndëshkimi ka vlerën kuruese:... ai duhet të ndihmojë në ndreqjen e fajtorit”. Detyra për ta mbrojtur ‘popullin e Hyjit’ që na është besuar ditën e shukurimit tonë ipeshkvor na ka nxitur pra që të shpallim dekretin në fjalë. Mendojmë se veprojmë për të mirën e personave që bëjnë vrasje, të shpirtit të tyre pas vdekjes, të familjeve të tyre, të bijve të pafajshëm. Në të vërtetë, neni 1034 i Katekizmit të Kishës Katolike thotë se “Jezusi flet vazhdimisht për ferrin që i

pret ata të cilët deri në fund të jetës nuk pranojnë të kthehen dhe ku mund të vritet si shpirti ashtu edhe trupi (Mt 10,28)”. Me ndërmjetësinë e Zojës së Këshillit të Mirë dhe të “Martirëve” tanë, Hyji e ndriçoftë mendjen e të gjithë njerëzve në mënyrë që të gjithë të mund të pranojnë këshillat e paqes, të faljes dhe të pajtimit.

Imzot Lucjan Avgustini, Imzot Angelo Massafra OFM Imzot Ottavio Vitale RCJ Ipeshkëv i Sapës Arqipeshkëv Metropolitit i Shkodër-Pult Ipeshkëv i Lezhës • Dom Robert Kola Kancelar, Atë Artan Seli SDS Kancelar, Atë Flavio Cavallini OFM Kancelar



SHOQATA “ATDHETARE – DUKAGJINI” Vendim nr. 666, date 13 maj 2003

Lagja “VOJO KUSHI”, rruga “ÇLIRIMI”, pallati 1261, Shkodër,
tel: 00355 222 43664, mob: 00355 692328116, adresa: www.
shoqatadukagjini.org, e – mail: nduesanaj@yahoo.it

Nr. 924 prot.

Shkodër, me 26 shtator 2012

DEKLARATË

Shkëlqesisë së Tij Imzot Angelo Massafra, Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë dhe Arqipeshkëv i Metropolitit Shkodër-Pult!

Përmes shpalljes në kishë dhe në media jemi vënë në dijeni me dekretin tuaj të datës 14 shtator 2012 ne lidhje me shkishërimin (dmth ekskomunikimin) e atyre që vrasin dhe e atyre që bashkëpunojmë më mënyrë të qëllimshme që kjo vrasje të bëhet.

Ne, Shoqata “Atdhetare Dukagjini”, **deklarojmë** se, dëshirojmë të bashkëndajmë me ju shqetësimin tonë qytetar në lidhje me fenomenin e vrasjes të përhapur dhe të shpeshuar të kohëve të fundit. Ne, si shoqatë punojmë në shërbim të komunitetit të Dukagjinit, kemi vënë dhe vazhdojmë ta kemi në qendër të vëmendjes fenomenin e gjakmarrjes, i cili është bërë pengesë serioze në përmirësimin e jetës sociale, ekonomike dhe shpirtërore. Përmes mediave dhe veprimtarive sensibilizuese jemi munduar të nxisim bashkëjetesën qytetare dhe kulturën e tolerancës si parakusht për respektimin e lirisë dhe dinjitetit njerëzor.

Ne vlerësojmë dhe përulemi me nderim përpara punës që ka bërë e vazhdon të bëjë kleri katolik në Shqipëri dhe me komunitetin dukagjinas në veçanti në shërbim të ngritjes shpirtërore, kulturore e ekonomike. Ashtu si në çdo etapë të rëndësishme të historisë sonë të dhimbshme, Kisha Katolike vazhdon të jetë në pararoje të edukimit të popullit drejt një të ardhme më të mirë, drejtë progresit bashkëkohor evropian. Natyrisht vendimi i fundit, padyshim që është një vazhdim i pandërprerë i kontributit shekullor tuaj në popullin tonë. Prandaj ju keni dhe meritoni mirënjohjen tonë të plotë.

Ne deklarojmë hapur mbështetjen tonë në lidhje me çdo ndërmarrje të tuajën që synon promovimin e vlerave të Ungjillit dhe jetës si një e drejtë dhe detyrë universale.

**Kryesia e Shoqatës “Atdhetare Dukagjini”
KRYETARI, NDUE SANAJ**

Lojë me historinë shqiptare në Ballkan

Na mësuani mësuat tonë dikur e ne vazhduam t’i mësojmë nxënësit tonë për historinë e lavdishme të kombit. Kush nuk ndihej krenar me gjithë këtë histori? Kush nuk merre pjesë në korin milionësh të këngëve atdhetare kushtuar datave e personazheve të historisë sonë? Këngët për trimat e atdheut u kënduan edhe në vitet më të vrara të Kosovës. U kënduan për të mbajtur gjallë kujtimin për trimat dhe betejat e mëdha dhe e kishin arritur qëllimin sepse me dekada e dekada e madje edhe me shekuj identiteti shqiptar po ruhej dhe po mbrohej. Edhe në betejat më të lavdishme të luftës për lirinë e Kosovës djelmosha e vajza shqiptare me këngën për trimat e për Shqipërinë kanë rrugëtuar drejt qëllimit sublim. Shekujt krijuan me ngjarjet e ndodhura historinë dhe shqiptarët as edhe një herë nuk ishin fajtor pse po ngjanin katrahura e tmerre. Pse po ngjanin luftëra, djegie, masakra e vrasje masive. Shqiptarët as edhe një herë nuk kanë vrarë e djegur civilë të pambrojtur e fqinjët e tyre këtë e kanë bërë me qindra e mijëra herë që besa. Por, në kohë e hapësirë me fajn e inatin mes nesh shqiptarët u barazuan me vrasësit e hijet e zeza sepse vetë kontribuuan për këtë.



Shqiptarët në Kosovë, një pjesë e tyre, kanë bërë tani e sa vite lojë me historinë tonë dhe për të marrë nga ca para në emër të projekteve për pajtim krijuan atmosferë se duhet harruar e kaluara dhe se duhet krijuar filma e projekte të rrejshme të pajtimit. Pa u kthyer ende eshtrat e njerëzve të vrarë e të tretur nga bandat vrasëse serbe dolën e po dalin individë, shoqata bastarde e kolumnistë që duan të na shpallin kosovar dhe që

kërkojnë të harrojmë historinë thua se ne jemi fajtor për gjithë tmerret në Ballkan me vite e dekada.

Duke parë këtë pozicionim tonin fqinjët vazhduan me talljet dhe lojën ndaj historisë sonë. Maqedonia e bëri Shkupin fragment të mesjetës dhe e krijoi ambientin më të tmerrshëm antishqiptar. Nuk u mjaftua me kaq po edhe botoi tekste shkollore për nxënësit shqiptarë me fyerjet nga më të rëndat për kombin e tyre dhe asgjë nuk ngjau. Individë e njerëz me emra shqiptarë në qeverinë e Maqedonisë shprehen injatë dhe u mjaftuan me kaq. Nxënësi shqiptar atje do të mësojë ne ato libra dhe sa më shumë që e fyen e shanë kombin e tij aq më të mirë do ta marr notën në ditar. Loja dhe tallja me historinë shqiptare po vazhdon në Ballkan e për këtë gjendje, më shumë se armiqtë, fajn e kanë shqiptarët sepse nuk janë të bashkuar dhe punojnë që ta zhdukin një pjesë të historisë. Punojnë e japin para që ta shkruajnë pjesën tjetër të historisë duke vënë si kryepersonazh vetën e tyre e duke mohuar gjithë të tjetër. T’i shikojmë bashkë tekstet shkollore të letërsisë, historisë e muzikës dhe do të shohim se jemi bërë komb me histori të harruar e të ndarë në fragmente.

Rahman Jasharaj

DOM PREK NDREVASHAJ NË SHKODËR

Me datën 8 shtator 2012, nën kujdesin e famullise së Shen Shtjefnit, të kisha e Motrave Stigmatine, në Gjuhador, Ndreke Guri u prezantua me librin "Dom Prek Vashaj", biografik.

Ne kete ceremoni moren pjese mjaft personalitete te qytetit Shkoder, nga zona e Dukagjinit, në veçanti theksojmë pjesëmarrjen e profesor doktor Mahir Hoti, Konsullin e Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqejza, Drejtorin e bibliotekës "Marin Barleti", dr. Gjovalin Çuni, mjeshtri Ahmet Osja e të tjerë.

Prezantimin e hapi dom Gjovalin Sukaj, pasi uroj pjesëmarrësit për prezencën e tyre në kete ceremoni, beri një prezantim të njohjes se tij me dom Prek Ndrevasen, i dha fjalën drejtueses se ceremonisë aktores se mirënjohur, Rajmonda Markut.

Ajo pasi lexoi pjese te ndryshme te librit, i dha fjalën redaktorit te librit, **profesor doktor Tef Topallit**, i cili ne mes te tjerave u ndal: "Po e quej kështu "të shejtë" këtë sallë të murgeshave tona, sepse një pjesë e mirë e këtij auditori e njeh se kjo aulë mban një histori për qytetin e Shkodrës dhe jetën e meshtarisë këtu; pa frikë mund të themi se Zoti i plotfuqishëm e ka shndërrua këtë prej 20 vjetësh, nga gjykatë për dënimin e klerikëve, në foltore për naltimin e veprës së tyne bariore e shpirtnore, siç po veprohet sot në promovimin e një libri biografik, kushtue një emri ndoshta të papërsëritshëm, si ai i dom Prekë Ndrevasës, birit të Dukagjnit, që vjen e ndriçohet në këtë ditë prej një biri tjetër të kësaj krahine, Ndreke Guri. Me siguri në këtë sallë do të ishte dënue edhe studenti i ri i kolegjes saveriane, sikur të mos kishte marrë rrugën e mërgimit këtu e para gjysë shekulli, ashtu si ishte dhanë dënimi kapital për mjaft të tjerë, midis të cilëve edhe për priftin gjerman dom Alfons Trackin, i cili qe ba mproje dhe udhërrëfyes e atë shpirtnor në rrugë të meshtarisë për jetimin e vogël Prekë Sokoli dhe motrën e tij, Alberta!

Aktorja e mirenjohur e teatrit "Migjeni" i jep fjalën poetit **Prele Milanit**, i cili nder te tjera theksoi: "Një jete ne shërbim te idealeve me te eperme njerezore! Një frat i thjeshtë me një shpirt të madh, një shërbetor i përvuajtur i shëlbimit, Një misjonar dhe bamirës i jashtzakonshëm, fjalëpak e punëshumë. Një jetë e panjollë e tera në shërbim te idealeve me te epra njerezore ku angazhimi dhe shpresa, bamirsia dhe ungjillizimi qenë personifikuar tek ai në sintezën më të goditur.

Nga fizionomia pati hiret e një burri fisnik ngarkuar me peshën motëve sa të vështira, dramtike aq të bukura e intesive e mbreslënëse sa për të shkruar në mënyrë modeste një emer në histori. Më fort i mesëm se i gjatë, një meshtarë i zakonshëm i veshur thjesht për të cilin pamja e jashtëm nuk është primare. I këndshëm, me një të folur plot njerëzi.

Kur e njoha unë mbante zyze, të cilat nuk ia mshefin dot gjallërinë atyre syve që shembëllenin, zgjuarsi, inteligjence, vullnet dhe fisnikëri. pra një figurë e kompletuar në të gjitha aspektet ...

Prekë Ndrevasaj ka mbetur i pa shlyer në kujtesën ish nxënseve dhe banorve të

zonës se tij ku punoj, jetoj, u miqësua dhe ndau me ta gëzimet dhe shqetsimet e jetës ë përditshme. Aty ku me zell dhe pasion të madh djalosharë ndezi pishtarin e dritës dhe diturisë tek fëmijët e atyre zonavave që tradicionalisht kishin qënë në erërsirën e thethllë të analfabetizmit historik që trashiguan shqiptarët nga bashkjetesa e gjatë dhe hidhur me Perendorinë Otomane. Prekë Ndrevasaj jetoj në shtëpinë e Arif Sulës në fashtin Ulanjet të Klosit, në një kullë tipike tradicionale Mati. Aty gjeti bujari respekt dhe dashuri njerzore, për të cilën siç thotë autori i këtij libri dhe miku i tij Ndreke Guri, Dom Preka ruajtë gjatë gjithë jetës mirënjohje edhe dashuri. Shaqir Sula, djali i Arif Sulës duk kujtur vitet e fëmirisë për ish mësuesin e tij të parë shprehet: *E kujtoj me shumë respekt jo vetëm si mësues të pa përsëritshëm, si një njeri shumë të ditur, shumë i shoqerushëm me njerzit, por edhe si një mik të madh të babait tim të ndjerë. Mësues Prenga këshu e kemi njohur (Prengë Sokol Prenga) dhe babai im bisedonin me orë të tëra sidomos mbrëmjeve për gjithfarë historish të vjetra e të reja, zakone, rite, e te tjera të gjithë e dinim se kishte studjue në shkollën fetare, katolike të Shkodër, të cilën e kishte mbydhur shteti dhe Prenga dukej sheshit se vunte shumë atë gjë. Ishte shumë besimtarë i mirë ai jo vetëm respektonte në mënyrën më shembudhore, besimin islam, por studjonte dhe kishte njohuri shumë thella e të sakta për islamin. Lexonte shumë dhe na recitonte me shumë pasion sidomos vargjet e Fishtës, Mjedës, Naimit, por edhe të autorëve klasik të leterisë botrore. Këtu në Ulanjet, Prekë Ndre Vashaj (Prengë Sokol Prenga), gjeti burimin e frymzimit për shumë vjersha madje edhe shkrime në prozë, fragmente të cilat mi ka lezuar shpesh dhe i kishte hellur në një fletorre shkrimi të qendisur me një bukurshkrim tipik konform abetare*

Figura e Dom Prkë Ndrevasajt vjen e plotë e vizataur në mënyrë realiste dhe mëmORIZUAR në mënyrë të pa shlyshme në Monografinë që autori Ndreke Guri na bën dhuratë në përvjetorin shekullorë të pavarsisë Shqipërisë.

Një monografi dinitoze, për një emer që i bën nderë historisë.

Një monografi që futet në kategorinë e botimeve speciale, e denjë për panairët e botimeve më luksoze të librit.

Një monografi e shkruar me një gegnishte elegante, me një gjuhë të rrjedhshme, lakonike dhe të pastër ashtu siç e fliste dhe shkruante vetë Dom Prekë Ndrevasaj.

Ndreke Guri në librin e tij me gjuhën e fakteve, me gjuhën e dokumentit me kujtimet e bashkëkohesve, pa u sforcuar krejt në mënyrë të natyrshme na tregon se kush

ishte Prek Ndrevasaj i cili i beri vënd vetës për të hyrë në histori.

Ky liber nuk vlen vetëm të lexohet, por edhe të studiohet, pasi vetëm duke u studjuar me kujdes do të mësojmë se Dom Prekë Ndrevasaj nuk qe vetëm një shërbetor përvuajtur i shëlbimit, por një itelektual me kulturë të gjerë, një patrot i cili jo vetëm themeloi kishën e parë shqiptare në shtetin e Miçiganit në SHBA, por këtë kishë e ktheu per tre dekata në qender të vëllazërimit, bamirsise, kultures e bashkimit shpirtërorë të shqiptarve.

Dom Prekë Ndrevasaj në këtë liber na shfaqet si mësues i shquar i gjuhës shqipe,

1992, të jetuemit me te për shumë kohë në Amerikë, të shërbyemit pranë tij në nevoja sa qe gjallë e deri në ditën e fundit që vdiq, kjenë rasa që e shtynë Ndreke Ded Gurin me shkru e me zhvillue dijen për një personë të randsishme të këtij kombi, që pak ishte i njoftun. Ai ja ka përcjellë tashma të tjerëve njashu siç ja ndin zemra dhe e siç ja krijon mundësia e talentit të lindun dhe të trashiguem nga trevat e malsisë.

Libri që po paraqesim asht kopirajt, ose pronë e Ndrekes, por edhe e jona. Ndjesia e shkrimit i takon Ndrekes, përvetsimi i asaj që shkruen na takon ne. Libri asht buka, brumi asht jeta misionare e priftit, por edhe misioni human i laikut.

Çdo libër nis ndoshta me gjanë ma tërëhjekse që mundet me kenë për lexuesin, me titullin që duhet me të tërëhjek. Ndreka librin e tij e titulloi thjesht "Dom Prekë Ndrevasaj". Mbasi e përfundon së lexuemi, të lind mendimi se këtij libri mundet me ju ngjitë edhe një tjetër titull që për mue kishte me kenë "Profile", sepse asht libri i jetës së Dom Prekë Ndrevasës, por edhe të një pjese të jetës mërgimtare të autorit, Ndreke Ded Gurit.

"Në emigracion mikesia e vëllaznia janë lulet ma të bukura, si me thanë ma të natyrshmet qi zakonisht mblidhen ndër lulajet e largëta të mërgimit"- shkruante përsëri vite ma parë Dom Lazër Shantoja.

Libri asht rrëfim i një miku për mikun e rigjetun plotësisht në mërgim. Mundena me thanë se janë rrëfimet e botës së vogël shqiptare të ndame në dysh. Qysh se u përpjekën të dy u lidhën me besë t'i shërbenin njani-tjetrit; njani me ndihmën e ingranimit në botën e përtej oqeanit e tjeri me kujdesin për jetën e një njeriu të lidhun në besë vetëm me Krishtin..

Fjalën e mori dhe **dom Preke Lazraj**, përgjegjesi i Radio-Marijes, i cili ne mes te tjerave foli per rolin e dom Preke Ndrevashes ne mergim dhe faalenderoj autorin Ndreke Gurin per punen e madhe qe ka bere.

Poezi per dom Preke Ndrevashes recituan dy motra Milani, si dhe aktorja Rajmonda Marku.

Pershendeti dhe foli per jeten e dom Preke Ndrevashes edhe **Frok Kola**.


Pastaj, ne emer te familjes se dom Prek Ndrevashes pershendeti te pranishmit **Kole Ndrevasaj**.

Te pranishmit i pershendeti autori i librit, Ndreke Guri.

Prezantimi i ketij libri u mbyll me nje koktejl.

I urojme Ndreke Gurit jete te gjate dhe me plote krijimtari te tjera.

Nga korespondenti "Dukagjini"



si bamirës, misjonarë dhe prisë i shquar i mergates shqipatre për tre dekada.

Pas recitimit te disa pjeseve poetike te dom Prekes, Rajmonda ja dha fjalën **dr. Gjovalin Çunit**, i cili nder te tjera u ndal: "Zotërinj asht një rasë i bukur me pa kaq njerëz të mbledhun në një sallë kishë. Duhet falenderue kush na grishi n'ket mbramje të sotme. Falënderimet ma s'pari i takojnë Ndreke Ded Gurit, por edhe shpirtit në lumni të Dom Prek Ndrevasës; i takojnë edhe çdo miku që e ndihmoi Ndreken me përcjellë me vërtetësi trajtesën e vet.

"Arti i shkrimit-shkruente D. Lazër Shantoja- për njat që e ushtron i jep kënaqësi, por edhe i shkakton trazime. Shkrimtari del para botës me një pajë vetjake përftimesh dhe ndjenjash. Ai ka diçka me thanë edhe e ndjen nevojë t'a thotë".

Jeta asht e mbushun me rasa. E këta rasa përbajnë fabulat e shkrimit. Të përpjekunit me dom Prekën qysh në vjetin

NJË NDARJE E DHIMBSHME DHE E PARAKOHSHME

Prof.as.dr. Vuksan KOLA
pedagog në Fakultetin
e Mjekësisë, UT, Tiranë

Me hidhërim të thellë i japim lamtumirën e fundit njeriut të dashur e të paharruar të familjes e të fafesisit, shokut, mikut e kolegut tonë të nderuar, mjekut të respektuar nga të gjithë, Dr. Prelë Gjeloshit.

Prelë Gjeloshi lindi në fshatin Kir të Dukagjinit, me 19 tetor të vitit 1955. Aty kaloi fëmijërinë dhe mbaroi me rezultatet shumë të mira shkollën fillore e 8 vjeçare. Arsimin e mesëm e lidhi me ëndrrën dhe dëshirën e tij të madhe, që një ditë të vishte bluzën e bardhë të mjekut, prandaj vazhdoi Shkollën Mjekësore në qytetin e Shkodrës, të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera.

Në pamundësi për të ndjekur menjëherë studimet e larta, detyrohet të kryej shërbimin ushtarak. Kjo ndërprerje e padëshiruar e arsimimit nuk mundi të shuaj për asnjë çast synimin e tij të qartë dhe këmbënguljen e pandërprerë për të marrë një të drejtë studimi për shkollën e lartë. Dhe kur arriti t'i vinte punët në vijë, zgjodhi plot pasion Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës. Atje, në konviktet e këtij institucioni, fati i mirë e sollti të mblidheshim së bashku, brenda pak viteve, 9 djem dukagjinas, të gjithë me vendosmërinë dhe përkushtimin e madh për t'u pajisur me sa më shumë njohuri nga shkencat mjekësore, për të cilat kishte aq shumë nevojë

i gjithë populli i Dukagjinit. Midis nesh ishte edhe studenti i shkëlqyer Prelë Gjeloshi. Shumë i njerëzishëm, fjalëpakë, i dashur e korrekt në shoqëri, i gatshëm për të ndihmuar këdo, studiues serioz e me kërkesa të pazakonshme për të marrë vlerësime maksimale në çdo lëndë, dashamirës e i thjeshtë me të gjithë, këto ishin disa nga tiparet që ishin skalitur më së miri në personalitetin e tij.

Pas mbarimit të Fakultetit të Mjekësisë, në degën Mjekësi e përgjithshme gjatë viteve 1979-1984, Dr. Prela fillon punë në vendlindjen e tij. Tashmë auditorët e universitetit ishin zëvendësuar me praktikën e përditshme mjekësore përballë njerëzve të sëmurë. Njohuritë e shumta shkencore, që nga shkolla e mesme e deri në vitin e fundit të fakultetit, nuk e zhgënjyeshin asnjëherë mjekun e ri. Afësitë e tij i kapërcenin disa herë nivelet e të tjerëve që xhironin korridorët e spitaleve të mëdha të qyteteve, por Dr. Prela, për disa vite, vazhdoi të shërbente qetësisht e me të gjithë përkushtimin e duhur në vendin e tij, midis bashkëfshatarëve të vet, që i donte dhe i respektonte aq shumë. Përpjekjet e shumta për të zhvilluar më tej njohuritë e tij në një fushë të veçantë të mjekësisë, pra për të marrë një spe-

cialitet, ranë gjithnjë në veshë të shurdhër. Fatkeqësisht, autoritetet shtetërore nuk i morën asnjëherë seriozisht kërkesat e tij, megjithëse ishin tepër të rrallë në rrethin e Shkodrës ata që kishin mbaruar për mjekësi me një me-



Dr.Prelë Martin Gjeloshi

satore të tillë. E megjithëkëtë, Dr. Prela vazhdonte të studioje e të punonte pa ndërprerje.

Më në fund, pas viteve 1990, vjen familjarisht në qytetin e Shkodrës dhe vazhdon të punojë si mjek i përgjithshëm, veçse përsëri larg, në periferi të saj. Për Dr. Prelën nuk kishte rëndësi vendi ku do të ushtronte detyrën e nderuar të mjekut. Pacientët e tij do ta ndienin gjithnjë pranë, natën e ditën, në dimër e në verë, në ambulancë e në shtëpi, dhe

kurdoherë me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë e të përkushtimit të pashoq, i gatshëm për të bërë të pamundurën në shërbim të ruajtjes së shëndetit të tyre. Sipas vështirësive praktike që shtroheshin përpara tij, komunikonte me shumë korrektësi e profesionalizëm me specialistët e ndryshëm në Shkodër e Tiranë, u jepte atyre mendime të sakta dhe zbatonte me kujdes rekomandimet që merrte prej konsultave të ndryshme. Pacientët shkonin te Dr. Prela pa druajtje, me sigurinë se do t'i priste kurdoherë mirë, me besimin e plotë se nuk do të kursente asgjë për ta, prandaj mori vazhdimisht mirënjohjen dhe respektin e tyre.

Fatkeqësisht, atëherë kur Dr. Prela ishte në kulmin e aftësive të tij profesionale, filloi ta gërrej nga brenda, tinëzsisht e pa pushim, një sëmundje e rëndë

dhe e pashërueshme. Ja që edhe mjekët janë si të gjithë të tjerët përballë kërcënimeve të jetës nga patologjitë e ndryshme. U bë gjithçka që mund të bëhej për të, brenda dhe jashtë Shqipërisë, por ishte e pamundur të shpëtohej jeta e këtij njeriu që do të mund të shpëtonte kush e di se sa jetë të tjera. Kështu u ndërpre në mënyrë të papritur dhe tepër parakohe udhëtimi i gjatë i Dr. Prelë Gjeloshit, por ai la pas një trashëgimi të madhe,

një emër të mirë e të respektuar mes njerëzve. Bashkë me gruan e tij ai rriti dhe edukoi dy djem të mirë që vazhdojnë studimet e larta në Itali, gjithashtu për mjekësi, Klodin e Benardin, të cilët tani ndihen tepër të pikëlluar për fatkeqësinë që u ka ndodhur, por që me siguri do jenë gjithnjë krenarë për babain e tyre dhe do të përpiqen pa pushim të ecin në gjurmët e tij, mundësisht duke mos lënë asnjë hapësirë pa plotësuar në atë zbrazëti të madhe që do të krijojë mungesa e babait. Vdekja e Dr. Prelës ka hidhëruar pa masë edhe pjesëtarët e tjerë të familjes: nënën e moshuar, vëllezërit dhe motrat, bashkëshortin e tij, por edhe të tërë fafesisin. Të gjithëve u shprehim ngushëllimet më të thella dhe i sigurojmë se ndajmë me ta të njëjtën dhembje shpirtërore.

Dr. Prelë Gjeloshi bën pjesë me dinjitet në ajkën e elitës intelektuale të Dukagjinit e më gjërë. Emri i tij i bën nder kurdoherë të gjithë kësaj krahine, në historinë e mjekësisë, së të cilës do të ruhet kurdoherë i gjallë e i paharruar portreti i tij si mjek dhe si njeri i jashtëzakonshëm. Dr. Prela do të mbetet gjithnjë i dashur e i respektuar edhe për të gjithë ne, shokët dhe kolegët e tij, që e njohën, që mësuam e jetuam me të, dhe që fatkeqësisht sot, pikërisht me 19 shtator 2012, vijmë në Shkodër jo për ta takuar me mall si dikur, por për t'i dhënë lamtumirën e fundit.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

RRËNJË DASHURIE

Me datën 22 shtator, ditën e shtune, në ora 11. 00, holli i teatrit "Migjeni" u mbush plotë e për plotë me dashamir të librit dhe të autorit Isa Alibalit se, paraqitej libri i gjashtë i tij, me titull "Rrënjë dashurie-shkodranet për Kosovën".

Në këtë paraqitjeje merrni pjesë shkrimtar, poet, artiste, studiues dhe dashamirë të librit të qytetit Shkodër, në veçanti mjeshtri Fadil Kraja, Ahmet Osja e Ndoc Gurashi, profesor dr. Alfred Çapaliku, Kryetari i Këshillit të Bashkisë së qytetit Shkodër, Bardhyl Lohja dhe miq nga Kosova.

Ceremonia filloi me interpretim në piano nga Eugjen Kraja. Pastaj e mori fjalën drejtuesja e ceremonisë, aktorja e mirënjohur dhe plote elegance, Merita Smaja, e cila pasi falënderoj të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, i dha

fjalën Mjeshtri Fadil Kraja dhe përshëndeti ashtu si e di ai vete.

Rita Dervishi-Mozartishoqëron në piano Çiljeta Deda.

I jepet fjalë përshëndetëse, mjeshtrit Ahmet Osja.

Përsëri në piano Mimoza Rakaj.

Drejtuesja Merita i dha fjalën kryetarit të Këshillit të Bashkisë së qytetit Shkodër, av. Bardhyl Lohja për të dorëzuar të nderuarit Isa Alibali, titullin "Mirënjohja e qytetit Shkodër" e dhënë nga Këshilli i kësaj Bashkie për kontributin e dhënë në fushën e kulturës në qytetin e Shkodrës. Me këtë rast përshëndeti dhe autori i librit, Isa Alibali.

Përshëndeti profesor Adem Bala.

Aktorja e mirënjohur Rita Gjeka, reciton poezinë "Kosovës" e shkruar nga Hamdi Gjylbegu, e cila me interpretimin e saj plote

elegancë, e forcë shpirtërore na dha shume emocione, bëri që disa herë të duartrokites nga pjesëmarrësit.


Pastaj, ansambli i muzikës qytetare nën drejtimin e Gazmend Krajes u kënduan dy këngë: "O zambaku i Prizrenit" nga Mimoza Rakaj dhe "Syni si qershia" nga Rita Dervishi.

Përshëndeti Nail Draga nga Kosova dhe profesor Alfred Çapaliku.

Ceremonia u mbyll nga një grup të rinjsh e te rejash me violine nën drejtimin e Viola Bajraktari.

Redaksia e gazetës "Dukagjini", Isa Alibalit i uron jetë të gjatë dhe me plote krijime të tjera.

Nga korrespondenti i gazetës "Dukagjini"



TIRANË, "GEER", 2012

Pianisti

Tregim nga LAZËR STANI
(vijon nga numri i kaluar)

5.

Shumë vite më vonë, kur nuk kisha asnjë shpresë për të ardhmen time si artist, në derën e shtëpisë sime trokiti një burrë i panjohur rreth të pesëdhjetava. I huaji tha se ishte drejtori i Teatrit Kombëtar të Operas. Unë e kqyra me dyshim, sikur po i thosha: Ç'drejqin kërkon nga unë? Pak më ka tallur jeta që të më tallësh dhe ti tani? Edhe këtë kisha mangut. Po burri, si të m'i kish lexuar mendimet në ballë (mirë thoshte Pepja se unë nuk di të fshihem) tha: "Dua të bisedoj me ty".

E ftova brenda. Pasi u prezantua dhe biseduam pak në dhomën e ndenjes, i huaji më tha:

"Dua të luash diçka për mua në piano, diçka tënden".

"Kam pesëmbëdhjetë vjet që jam larguar nga bota e muzikës, i thashë. Ç'do të dëgjosh nga unë?". Dhe sikur po flisja me vete shtova: "Ose më mirë të them, nuk kam qenë kurrë në atë botë".

"Megjithatë ti do të interpretosh diçka për mua", këmbënguli tjetri.

Krejtësisht i befasuam nga kjo situatë, u ngrita në këmbë. Edhe ai u ngrit pas meje dhe të dy shkua në dhomën e pianos, ndërkohë që porosita Linën të na përgatiste diçka për drekë. Luajta një pjesë, dy, tri. Ai më ndiqte në heshtje dhe sapo mbaroja unë, më thoshte: Edhe një tjetër. Në fund, kur më të vërtetë, nuk po kuptoja më asgjë se çfarë kërkonte ky i

huaj, ai më tha: "Nuk kam dëgjuar kurrë një pianist më të zotin. Perëndia të ka bekuar me këtë talent që ke".

Gjuha më ishte lidhur. Nuk isha i sigurt nëse tallej, nëse ishte ndonjë rreng i artistëve të qytetit, ish-shokëve të mi të shkollës, apo ai fliste seriozisht. I huaji tha se në vjeshtë do ta çelte sezonin me një koncert recital timin. Përgatitjet do të filonin pas dy javësh. Më pyeti nëse kisha ndonjë kërkesë të veçantë, por unë isha aq i hutuar sa nuk nxirra dot një fjalë nga goja. Ai tha se do ti rregullonte vetë të gjitha dhe se kontratën do ta nënshkruanim, kur të takoheshim në kryeqytet pas dy javësh.

Në darkë vonë, pasi i huaji ishte larguar, Lina më tha të mos çuditësia. I kishte shkruar tre letra të gjata fshehtas meje dhe i kishte treguar gjithçka për mua.

"Më fal, tha. Po nëse do të të tregoja ty, nuk do më lejoje kurrë".

E përqafova Linën, e shtrëngova, e putha fort në buzë. Në faqe ndjeva lotët e saj të nxehtë. Ajo po qante. Dhe lutej nën zë përmes dënësjeve. Edhe pse nuk ia kuptoja fjalët e shqiptuara mbyturazi, e dija se lutej për mua.

Pas asaj mbrëmjeje të lumtur erdhën ditët e gjata dhe të shurdhëta të pritjes. Një javë, dy javë, një muaj, dy, tre.... Dhe prapë asgjë. Asnjë përgjigje, asnjë ftesë për të shkuar në kryeqytet. U ktheva prapë në zanatin tim, tregtinë e bagëtiive. Vendosa t'i shtoj biznesit tonë edhe rritjen e bletëve, sado që Pepe ishte kundër. "Jemi ende të rinj, kundërshtonte. S'na ka lëshuar takati". Por në fund Pepe u dorëzua dhe unë bleva njëzet zgjoje bletësh dhe i vendosa në oborrin e

pasëm të shtëpisë. Bleva dhe dy libra për rritjen e bletëve. Në pranverë do merresha me shtimin e tyre. Gjithmonë i kam dashur bletët edhe pse mjaltin nuk e vë në gojë. Lina më shikonte më dhembje, por as unë as ajo nuk e zinin kurrë në gojë historinë e koncertit në kryeqytet.

Një mbrëmje, ndërsa po rrinim të dy në verandë, të struktur pranë njëri-tjetrit në kanapenë e vjetër ajo lëshoi një psherëtimë të thellë dhe mërmëriti: "O zot, për pak desh të humba!" Më kapi fort për krahësh e më tërhoqi nga vetja, sikur donte të më shpëtonte nga mbytja. Unë po i bindesha vullnetit të saj, pa e kuptuar se përse ajo i thoshte vetes: "O zot, sa e trashë jam, sa e trashë". Dridhej në krahët e mi dhe mezi merrte frymë. Unë i përkdhelja kokën dhe përpqesha ta qetësoj.

Nga përtej oborrit u dëgjua një hungurimë e trishtuar qeni. Pastaj një tjetër hungurimë nga dikund tjetër, e largët dhe e pikëlluar, si kuje. Maçoku ynë, Miroshi, vraponte i shqetësuar nëpër verandë, hidhej sa në një parmak në tjetrin dhe ia ngulte sytë kërcënueshëm errësirës. U ngrita dhe u mbështeta te parmaku i verandës që binte nga rrugica e errët. "Ah, këta qenë të mallkuar", mërmërita me vete. Ndoshta në atë orë të vonë të mbrëmjes dikush po jepte shpirt. Thonë se qentë hungërojnë kështu në vdekje.

U shkëputa nga parmaku i verandës ku isha mbështetur. Ktheva kokën dhe pashë hijen e Linës që zgjatej tej përtej verandës, duke formuar një njollë të errët në murin pranë dritarës. "Unë të shkatërrova, tha Lina pa e kthyer kokën nga unë. E di se nuk do më falësh". Nuk i ktheva përgjigje. U futa në dhomën e pianos dhe nisa të

luaj atë motiv të trishtuar, që mbushte me pikëllim humbëtrën e natës. Më ngjante se dyshemeja po shkërmoqej nën këmbët e mia dhe që të mos fundosesha, përpqesha të mbahem mbas tingujve. Po luaja në piano rënkimin e yjeve që bien.

Pas asaj mbrëmjeje në verandë, kur unë luaja muzgjeve në piano, Lina nuk vinte më të ulej pranë meje dhe as kërkonte t'i dëshifroja kodet e çuditshme në pentagrame. Dilte më fëmijet në oborr e luante me ta, sikur unë të mos ekzistoj.

Po sot, aty rreth orës katër të mëngjesit a pak më herët, edhe pse nuk pres më ndonjë lajm nga kryeqyteti, pashë në ëndërr pikturën e çuditshme dhe Monikën. Dua ta rindërtoj dhe njëherë ëndërrën, t'i bashkoj fragmentet e mbetura andej-këndej, por e kam të pamundur. Zgjimi është i egër, ngjan me një sulm barbarësh.

Hap sytë në errësirë, zgjas dorën e shtyp çelësin e abazhurit. Dhoma mbushet me një dritë të zbehtë, të pafuqishme dhe faqja e murit përballë shtratit boshatiset nga tabloja. Rikthehet në ngjyrën e saj të zakonshme prej petalesh të trëndafilave të egër, një rozë e lehtë dhe pothuajse kundërmuese. Edhe pse është ende herët, tani do të bëj kafënë dhe do ta pi në verandë, ndërsa Lina dhe fëmijet flenë. Mbasdite, nëse nuk më del ndonjë punë e paparashikuar, do të shkoj nga motra ime piktore dhe do t'i tregoj për tablën që mu shfaq në ëndërr natën që shkoi. Nuk e di nëse është shenjë e mirë apo e keqe. Gjithçka më duket pakuptim.

Nga Lazer Stani,
Tiranë, qershor, 2012

SESIONI SHKENCOR PLAVA DHE GUCIA NËPËR SHEKUJ

Për dy ditë me rradhë në shtëpinë e kulturës në Plavë të Malit Zi, u zhvillue sesioni shkencor: "- Plava dhe Gucia nëpër shekuj", organizuar nga OJF "Alpet Shqiptare" të Malit Zi.

Merrnin pjesë delegacione të ardhura nga Shqipëria, Kosova, Mali Zi, si dhe komunitet shqiptarë nga SHBA, Gjermania, Zvicera dhe Belgjika.

Kryesia e punës drejtoi punimet nga:

*Prof. Dr. Akademik Marenglen Verli, nga Tirana.

*Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, Drejtor Institutit Historisë Prishtinë.

*Tahir Gjonbalaj, përfaqësues i OJF "Alpet Shqiptare", Plavë.

*Hasnije Kukaj – Gjonbalaj, përfaqësuese e forumit të grues, Plavë.

Në fjalën e hapjes itelektuali z. Tahir Gjonbalaj, në emër të OJF "Alpet Shqiptare" falenderoj pjesëmarrësit e ardhur nga Shqipëria, Kosova dhe nga komuniteti vendor Shqiptarë në Mal Zi, SHBA, Gjermani, Zvicër dhe Belgjikë, si dhe uroj për një punë të mbarë dhe të sukseshme "-Sesionin Shkencor Plava dhe Gucia nëpër shekuj".

Sesioni shkencor i zhvilloj punimet në tri seanca shkencore, duke u ligjeruar 16 kumtesa. Në seancën e parë foli Akademiku Prof. Dr. Marenglen Verli, nga Tirana me kumtesën e tij: "Veshtrim rreth kontributit të Plavës e Gucisë në Rilindjen Kombëtare Shqiptare". Pastaj e mori fjalën Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë Prishtinë: "Qendresa e Plavës dhe e Gucisë kundër Malit të Zi në kohën e LSHP. -Ndërsa znj. Hasnije Kukaj – Gjonbalaj, përshëndeti pjesë-

marrësit në emër të intelektualit Idriz Lamaj, i cili jeton në SHBA.

Me mjaft interes u ndoq kumtesa e Prof. Dr. Pllumb Xhufi: "Plava dhe Gucia në dokumentet e shek. XVII". - Prof. Dr. Mevludin Dudiq – Rektor i Universitetit të Novi Pazarit,



Në foto pjesëmarrësit duke ndjekur sesionin shkencor

u durtrokit disa herë gjatë ligjërimit të tij. - Prof. Dr. Isa Bicaj lexoj kumtesën: "Pushtimi i Plavës dhe i Gucisë nga Mali i Zi me 1912-1913". - Prof. Dr. Seit Mancaku foli rreth: "Identiteti gjuhësor i Shqiptarëve të Plavës dhe i Gucisë". Seanca e paraditës u mbyll me kumtesën e Prof. Dr. Frasher Demaj: "Alternativat e diplomacisë së Fuqive të Medha për Kufirin Shqiptarë – Malazet, në Konferencën e Ambasadoreve në Londër".

Seancën e dytë e hapi Prof. Dr. Zymer Neziri, nga Instituti Albanologjik i Prishtinës: "Lahutarët e Vuthajve dhe të Martinajve në fondet arkivore Amerikane".

Halil Bucpapaj foli rreth: "Vlerat dhe kon-

tributet atdhetare shqiptare në Plavë e Guci".

Ndërsa Ibrahim Hajdarmataj, përfaqësues i OJF "Mësuesi" për përfekturën Kukës mbajti kumtesën: "Kontributi i Malesisë së Gjakovës në Plavë e Guci në vitin 1912".

Seancën e tretë e hapi Prof. Dr. ErLis Durmishi me bashkë autor Ilir Bucpapaj: "Ekosistemet Malore: Treva Alpine e Alpeve Shqiptare". -Mr. Defrim Gashi, drejtor i drojtorisë inspektimit në ministrinë e Arsimit në Prishtinë ligjëroj: "Disa të dhëna nga shty-pi Austro-Hungarez për Plavën e Gucin me

1878-1881". -Ali Daci dhe Xhemajl_Kumnica, folen për: "Luftërat e Shqipërisë etnike 1941-1945". -Bashkim Rrahmani, nga Gjakova u ndal "Statusi Juridik i Kosovës 1945-2011".

Binak Ulaj: "Përdorimi i Flamurit Kombëtar Shqiptar pas Luftës dytë Botërore në Plavë e Guci". -Isa Nikifoli për: "Fisi i Rugovës në shtëgtimin historik".

Me mjaft interes u shikue edhe ekspozita në pikturë nga Mr. Endrit Musai: "-Plava dhe Gucia në dokumentat e AQSH-së".

Në fjalën e mbylljes Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë në Prishtinë, falenderoj OJF "Alpet Shqiptare" me përfaqësues z. Tahir Gjonbalaj për punën e mirë të bërë, për organizimin e këtij sesioni shkencor, në këtë vit jubilar të 100 vjotorit të Pamvarsisë të Shqipërisë, duke u cilësuar organizim i parë i këtij lloji. Gjithashtu z. Bajraktari falenderoj komunitetin e Plavës dhe komunitetet Shqiptarë të ardhura nga SHBA, Gjermani, Zvicër dhe Belgjikë, si dhe kardialogun mjekun me famë Dr. Ahmet Ulaj nga Tirana për punën e mirë në drejtim të oragnizimit në këtij sesionit shkencor. Falenderoj delegacionet të ardhura nga Shqipëria, Kosova dhe Shqiptarët e Mali Zi, për seriozitetin, larmim për kushtimin e tyre në një nivel të lartë të përgatitjeve dhe ligjerimeve të kumtesave të tyre.

Ky sesion shkencor i mbylli punimet me sukses, duke shpresuar në rradhë të parë tek itelektualët e komunitetit shqiptarë të Malit Zi, se në të arthmën do të organizojnë edhe sesione të tjera shkencore, për të hedhur dritë mbi të vërtetën e hidhur historike që ka kaluar populli shqiptarë i shumë vuajtur në breza.

Nga Ibrahim HAJDARMATAJ

FILLOI KURSI I GJUHËS SHQIPE NË VARESA-MILANO

Fëmijët e emigranteve shqiptare që banojnë në provincën e Varese të Italisë, fale iniciativës së sipërmarrësit Dukagjinas, nga Fshati i Planit te komunes Pult, Gjon Shtylleza, të mbështetjes dhe bashkëpunimit vullnetar të shoqatës "L'Orizont" dhe mbështetjes së shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" u bë e mundur fillimi i mësimi në gjuhën shqipe, ditën e shtunë, me 22 shtator 2012, në mjediset e shoqatës "L'Orizont". Fëmijët shqiptare në këto mjedise do te kenë çdo

të shtunë sallën e tyre për vazhdimin e mësimi. Mësuesja, Mereme Stafa me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies. Librat e siguruar nga Gjon Shtylleza, me te cilat fëmijët janë pajisur me Abetare, fletore të punës, si dhe me librin e gjuhës shqipe. Fillimisht, nxënësit janë nga prefektura e Qarkut të Shkodrës, por janë duke u regjistruar dhe nga krahina të tjera të Shqipërisë që banojnë në këtë rajon.

Në një atmosferë feste, fëmijët dhe

prindërit shqiptare do të ndjejnë tingullin e bukur të gjuhës shqipe. Në ditën e parë të shkollës prindërit dhe fëmijët e pranishëm në komunën Olgiate Olona, kanë shijuar libra dhe botime në gjuhën shqipe të dhuruar nga anëtarët e kryesisë së shoqatës "Atdhetare Dukagjini" me qendër në Shkodër, Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer Kodra, Tone Deda dhe botime të kësaj shoqate. Duam të theksojmë se ende shteti shqiptar nuk ka mundur të ndërtoj një shkollë në Itali

edhe pse komuniteti shqiptar është i dyti për sa i përket numrit të emigranteve. Çdo ditë e me shume prindërit shqiptarë po ndeshen me vështirësi të mëdha në komunikimin e gjuhës amë siç ndodhi me kthimin e një numri të madhe fëmijësh të emigruar në Greqi. Në këtë shkollë fëmijët do te kenë programet për klasat e para dhe te dyta. Mësimi është falas.

Nga Zef Nika, Varese, Itali



Fjalë të urta

Grumbullua nga Florinda Ndoja

"Ndryshimi midis nje personi të ndershëm dhe një personi të korruptuar është se personi i korruptuar ka një 'çmim', ndërsa personi i ndershëm ka një vlerë." "Kurrë mos i dëgjoni ata që flasin keq për të tjerët, e mirë për ty."

- Leo Tolstoy -

Vetëm ata që guxojnë të humbasin shumë, mund të arrijnë shumë.

- John F. Kennedy -

Një ditë një njeri i pasur i dorëzoi një shportë me fruta të prishura një njeriu të varfër. Njeriu i varfër buzëqeshi dhe u largua me shportën. Më pas e boshatisi atë, e lau dhe

e mbushi me lule të bukura. Kur njeriu i pasur u kthye, ia dha. Njeriu i pasur u habit, dhe i tha: "Perse më dhurove lule të bukura kur unë të dhashë plehrat?"

Dhe njeriu i varfër i tha: "Gjithkush jep atë që ai ka në zemrën e tij!!"


Atë që të bën keq dhe të mundon, turpëroje me heshtjen dhe me mosreagimin tënd ndaj tij."

Njeriu ka shpikur bombën atomike, por asnjë mi në bote sdo të ndërtonte një kurth për minjte.

- Albert Einstein -

Ne jete do te takosh tre lloje njerezish: ata qe do te ndryshojne jeten, ata qe do te shkaterrojne dhe ata qe do te jene jeta juaj.

Nëse një femër tjetër të "vjedh" mashkullin tënd, atëhere hakmarrja më e mirë është ta lesh atë të shkojë.



www.urtesi.com

Dhurata më e bukur që mund tu bësh njer-ezve që të rrethojnë është Buzëqeshja.

Dhurata më e bukur që mund t'i bësh familjes është Krenaria.

Dhurata më e bukur që mund t'i bësh shoqërisë është Besnikëria.

Dhurata' më e bukur që mund t'i bësh personit që do është Singëriteti.

- Kur të tjerët mundohen të të ulin, kuptoje se për ta je shumë lart!

- Njeriu i singërtë si bën keq askujt veçse lëndon veten ...;

- Meshkujt e vërtetë nuk "vidhen" ...

KONTRIBUTI I ARBËRESHËVE PËR BASHKIMIN E ITALISË

- ARBËRESHËT KRAHU I DJATHTE I GARIBALDIT -

Populli i Luganos ishte i bundin se Italia nuk munde te bashkohej nga "Kavuri", por vetëm nga Garibaldi, nga shpata e tij, vetëm ne lufte te armatosun. Dhe, kjo lufte për te nuk kishte përfundue ende, dhe zani i popullit thoshte: "... Ec përpara pa u trembur se ai do te ndjekoje ...". Dhe me te vërtetë shqiptaret e Luganos e ndoqën Garibaldin, ata i dhanë 500 vullnetare te vendosun, kushtue luftës për Liri. Garibaldi i ngjante "Anteut", por pa rrezik te shkëputej nga toka. Vetëm Ai ishte ne gjendje te bashkonte Romen me te gjithë-Italinë deri ne Alpet. Dhe vetëm deri atje, Ai nuk lakmonte tokat e te tjerëve. Banoret shqiptare te Luganos donin veç aq sa ju takonte, dhe asgja ma shum. Vetëm kjo Itali ishte e italianeve, dhe luganezet ishin te bindun se lufta për Liri dhe për drejtësi e bante njeriun te pavdekshëm. Për ta, pa dyshim ishte dhe Garibaldi.

Ai asht nder te paktet shpirtna te medie që shpjegojnë Legjendën, sepse janë shum ma te gjame se çdo kategori njerëzore e historisë.

Ai asht me te vërtetë-HERO! Te Ai nuk shprehet forca e traditës, por gjenia e nji mase te re popullore që kape naltesite Qiellore. Dhe, Viktor Hygoi kështu e përshkruan Garibaldin: "... Garibaldi! Cili asht Garibaldi? Asht njeri, jo ma shum, por njeri me plot kuptimin e ksaj fjale! Njeri që lufton për Lirinë, njeri që mishëron ne vete vehten gjithë njerëzimin ...". "Burrë i shkëlqyer!"-do te thoshte bashkatdhetari i tij-Virgjili ... Ku qëndron pra, fuqia e Tij? Kush e ndihmon atë? Pse fiton Ai? Shpirti i Popullit! Garibaldi asht hero popullor! Prandaj edhe shqiptaret e Italisë ishin te

gatshëm ta ndiqnin atë kudo, me besim te plote se do te arrinin fitoren. Shqiptari arbëresh-Luigj Scutari (Shkodrani) shkruante kështu ne poezinë e tij për Garibaldin: "Pse po ikën, te duam ma shum se sytë / Te duam aq shum, edhe me djallin te luftosh / Do te vijmë me ty edhe ne Ferr / Dhe do t'i thyejm brijte anmikut / ...". (K. Xoxe-"Shqiptaret dhe Garibaldi").

Ne mesazhin e naltpermendun del fare kjarre karakteri shqiptare i origjinës Arbënore, ku trimnia, bujaria dhe besa janë kryefjale-(autori M. B.). Ata e konsideronin vehten pas ardhës te denje te Gjergj Kastriotit dhe te Marko Boçarit. Ne rast se sot kemi humbe nji pjese te ndjeshme te ktyne cilësive brilante, shkaku duhet t'na shpjegojnë historianet ne kte 100 vjetor, pa asnji ekuivok. Gjergj Kastrioti kishte luftue për mbrojtjen dhe Lirinë e Atdheut te vet kunder pushtuesve osmane, ashtu si Garibaldi kundër pushtuesve te huaj. Gjergj Kastrioti kishte luftue për te krijuar shtetin shqiptar, si te vetmin mjet për te mobilizue te gjitha burimet e vendit ne luftën për Liri. Te njëjtën gja bante edhe Garibaldi. Gjergj Kastrioti-ishte i drejte, ai dënonte dhe falte kur duhej me fale, i tille ishte edhe Garibaldi, cilësi kto te moralit kristian. Heroi i ynë Nacional gjithëcka e vinte ne interes te Atdheut e te Popullit te tij, ashtu si dhe Fatosi Italian-Guseppe Garibaldi.

Shqiptari i Italisë-Gulielme Karlo, me te drejte shkruante: "... Ne jemi italiane (për shqiptaret e Italisë), dhe veprat e gjithë kapedaneve te Italisë duke fillue me Jul Çezarin dhe deri tek Garibaldi na "dehin" dhe na hjedhin ne zjarrin e entuziazmit, por kurrë mendojmë për origjine

tone shqiptare, dhe për heroin t'one-Gjergj Kastriotin-na pëlqen te vëmë përballë këmishës se kuqe te Garibaldit edhe krahu e çveshun te Gjergj Kastriotit. Zjarri i heronjve te medie, si Gjergj Kastrioti dhe Guseppe Garibaldi, ishte për shqiptaret e Italisë nji pista i përjetshëm që nuk shuhet kurrë. Po, Marko Boçari? Ky shqiptar i Madh i Sulit te Çamërisë, ky "tmerr" i turqve, siç e quante atë pjesëmarrësi dhe luftëtari i Komunës se Parisit-dijetari Francës-Zhak Elizr Rekly (1830-1905), ka gjana te ngjashme dhe te përbashkëta me Garibaldin. Boçari ishte lindun ne vitin 1790 ne Sulin e Çamërisë dhe vdiq si hero ne lufte kundër turqve ne vitin 1829. Emnat e shqiptareve arbereshe që luftuan për krah Garibaldit janë me qindra, nder te cilët mund te shquajmë: Paskale Bato, Rafael Kamadeka, Domeniko Maurja, Vicenco Maurja, Vincenco Sandrigo, Gavril Dara i Ri e shum te tjerë. Me te drejte pohonte Sami Frashri: "... janë me dhjetëra dhe me qindra fatosa shqiptare që ia zbardhen faqen Garibaldit dhe Italisë. Sami Frashri ne enciklopedinë e tij (1856) thotë se shqiptaret, vetëm ne Kalabri ishin 150 000 vete dhe se, ne gjithë Italinë arrinin ne 300 000 vete ...". Cilido shqiptare i vërtetë do te konstatoje me keqardhje se, kte emigracion "biblik" na e shkaktoi pushtimi i tejzgjatun afro pese shekullor osman. Kte fakt sa te idhet dhe tragjik duhet ta njohin dhe ta interpretojnë drejt politika shqiptare, jashtë çdo slogani për interesat e marrjes apo mbajtjes se pushtetit.

Janë nëmet e arbëresheve që na kane shoqnuë gjate nji shekulli, ndaj jemi te fundit ne hartën e Evropës. Me tokat e bujqve arbëreshe, Porta e Nalte Osmane stimulonte mercenaret shqiptare dhe kolonët. Vetëm ne Shqipni u krijuë klasa aristokrate orientale.

Nji 100 vjetori i Shpalljes se Pavarësisë duhet te festohet me madhësi, dhe me nji refleksion te sinqerte ndaj vllazneve te vërtetë te nji gjaku, dhe te demaskohen fuqishëm feudalet mercenare, te cilët i shërbyen çdo pushtuesi. Çdo shqiptar ka te drejte te krenohet me lepre e vllazneve arbëreshe. Vete fakti që arbëreshet e Ital-

isë hidheshin ne beteja me emnin e Gjergj Kastriotit dhe te Marko Boçarit, dëshmon me se miri se sa te vogla e te ndryshkuna janë ato penda, që vjellin vnere kundër Gjergj Kastriotit e Pjeter Bogadanit, dy "Korifejt" që nderojnë, jo vetëm Nacionalitetin tone, por qytetërimin, dhe mbare kulturën evropiane. Për te kujtue dhe respektue sencin e fuqishëm Atdhetare te arbëresheve duhet t'iu referohemi vargjeve te poetit Arbëresh-Zef Serembes, ne mes te cilave theksojmë: "Shqipëria përtej detit / na kujton se te huaj jemi ne kte dhe / sa vite shkuan e zemra nuk harron / se turku përgjithmonë, na la pa atdhe / ...". Çdo shqiptar i vërtetë, qofte ky edhe me nji minimum njohje ne fushën e historisë, e din shum mire se, ishin "sirenat" e arbëresheve, ato që zgjuan ndërgjegjen e përgjumun te shqiptareve, që ne mesin e shekullit XIX. Ishte arbëreshi i Madh-De Rada, që do te sillte ne kujtesën e shqiptareve "te harruarin"-Gjergj Kastriotin përmes te Përkohshmes se Tij "Flamuri i Arbrit". Ai frymëzoi lenden e pare te atdhetarizmit-vllaznit frashelij. Ishte Samiu, Avdyli dhe Naimi, te cilët ndonëse nen pushtimin osman, shkrinë energjitë e tyne për Atdheun.

Qe nga Lidhja e Prizrenit, dita e Shpalljes se Pavarësisë, te kujtohet De Rada dhe nxënësi i Tij, shqiptari pa njolla, Kryedemokrati-Luigj Gurakuqi. Te dy kta burra te medhej meritojnë Shtatore ne mes te Kryeqytetit tone-Tirane. Vetëm kështu mund te pretendojmë se jemi demokrat te vërtetë, dhe që aspirojmë për te qene qytetare te ndërgjegjshëm te Evropës.

Duhet ti kujtojmë çdo shqiptari se, Luigj Gurakuqi nuk ishte komunist. "Ai ishte djalë tregtari dhe Ministër i Thesari, dhe kur u vra pabesisht, e kishte barkun gjysme bosh ...", theksonte Kole Kamsi, shok dhe mik i Gurakuqit. Jam i mendimit se, Luigj Gurakuqi, asht "Emblema" antikorrupsion, "antibiotiku" ma produktiv ndaj ktij "virusi".

Nga Mark Bregu

FSHATI NËNMAVRIQ

Nga Zef Nik Krypçi

Në vitin 1670 Shala ka pasur 30 shtëpi me 200 banor. Në këtë kohë banore nga krahu i majte i Lumit të Shalës kaluan ne krahu e djathte të këtij lumi dhe aty gjetën toka të pabanuara dhe të pa emër.

Meqenëse në atë kohë nuk kishte emër tjetër vetëm fshati Mavriq, që shtrihej, në Jug te territorit te ketij fshatit, Gimaj sot. Ata kishin ardhur nga fshati Mes i rrethit Shkodër pas vitit 1418 në kohën e pushtimit nga Republika e Venedikut. Banorët e lartpërmendur e emëruan fshatin e tyre Nënmaivriq.

Me kalimin e kohës dhe shtimin e banorëve lindi nevoja e kërkimit për toka të tjera në këtë zonë për të mbijetuar. Ata gjetën toka të pabanuara afër qytezës së Dakajve. Aty gjetën edhe një burim uji me vlera të mëdha për nevoja jetike për këta banor.

Në shekullin e kaluar këta banor e emëruan këtë burim Gurra e Nosh Bacit. Këta banor meqenëse zunë vend afër



kësaj qyteze e emëruan fshatin e tyre, fshati i Dakajve, sot pjese e Nënmaivriqit.

Emri i kësaj qyteze mendohet se ka ekzistuar përpara lindjes së Krishtit. Sot në Rumani është një zonë malore me emrin Dakët e Transilvanisë. A mund të besohet se këta dy emra kanë lidhje me njëri-tjetrin?! Kjo mbetet vetëm hipotezë. Banorët e këtyre dy fshatrave Dakaj dhe Nënmaivriq thonë edhe sot se kemi lidhje gjaku me banorët përtej lumit të

Shalës.

Nga perëndimi i kësaj qyteze është edhe sot një rrugë mushku që të çon në majën e kësaj qyteze. Në majën e saj është një kishë me emrin kisha e Shën Prenes. Aty janë katër mure nga 1. 5 m lartësi pa çati, sipërfaqja e saj nuk është më e madhe se 16 m2.

Brenda këtyre mureve janë tre varre paralele njëri me tjetrin, askush nuk e din se të cilës periudhë u përkasin. Këto varre mund të jenë edhe të klerikëve që kanë shërbyer në këtë kishë. Thonë se princi i Pultit poshtëm, Pjetër Spani e ka pasur qëndren administrative në këtë qytezë 1432 – 1454, i cili ne vitin 1454 u vra ne lufte.

Në librin "Historia" në periudhën e Gjergj Kastriotit, prof. dr Selami Pulaha shkruan: "... në vitin 1485 në kalanë e Mavriqit në fshatin Gimaj sot, është instaluar një garnizon ushtarak Turk. Poshtë në fshatin Dakaj në një kodër është një vend varrezash as kush nuk din se të cilës kohë i përkasin, por mendohet se banorët që kanë banuar në këtë qytezë nuk kanë pasur mundësi ti varrosin të vdekurit

përveçse në fshatin poshtë për arsye të terrenit të vështirë në qytezë. Prej ku del burimi i ujit deri në prrua të Dakajve afër qytezës është hapur një kanal 300–400 ml, i ndërtuar me gurë anësor dhe i mbuluar me rrasa guri me qëllim që banorët që kenë banuar në qytezë ta kenë ujin sa më afër për nevojat e tyre.

Në vitin 1967 kooperativa bujqësore e fshatit Gimaj dhe e fshatit Nënmaivriq me vendim të shtetit të asaj kohe filluan hapjen e rrugës automobilistike Gimaj-Nënmaivriq. Gjatë punimeve afër qytezës dolën nga nëntoka objekte arkeologjike të pa para ndonjëherë sidomos në veri të Shqipërisë.

U gjetën copa pjatash, copa filxhanash, argjile me ngjyra, me figura të teknologjisë të ditëve tona. Këto objekte i kam parë me sy dhe i kam prek me dorë para katërdhjetë vjetësh. Por në atë kohë nuk kam qenë i interesuar si sot, në asnjë kohë dhe asnjë herë nuk është interesuar kush për studime historike as për kërkime arkeologjike në këtë qytezë në veriun e Shqipërisë.

NJË DINASTI ARTISTËSH ...

Jemi komshi te hershem me familjen Smaja. Një familje e njohur ne Shkodër. Familje e vjetër shkodrane, e fisme, e urte dhe e ndershme. Nga ato familjet qe vegjetojnë ertësi dhe devocion. Nga ata familje qe nuk vrapojnë duke kërkuar privilegje dhe mirënjohje. Por është, ajo, mirënjohja qe vrapon pas tyre, madje edhe lavdia, kujtimi e nderimi rizgjojnë here pas here atë çka kane te vyer familje te tilla, gjurmët qe lanë nder mote për te mirën e shoqërisë ... Për te mire e Shkodrës, qytetit ku jetuan dhe jetojnë. Dhe unë kam kënaqësinë, madje një detyrim moral e te ligjshëm te ve ne dukje pikërisht atë qe e karakterizon dhe etiketon këtë familje te fisme. Eshte një vatër, apo një fole ku gjallojnë plot "figli d'arte" (bij arti).

Eshte e njohur dëshira e shume prindërve, dëshira qe nganjëherë kalon deri ne mani qe fëmijët e tyre te bëhen ashtu siç dëshirojnë ata, shpesh, te ndjekin profesionin e tyre. Te bëhen "bij arti" siç thuhet ne rilindjen italiane për djem apo vajza qe trashëgonin profesionin e prindërve duke e çuar atë ne shkallet me te larta. Por, mjerisht rralle ngjiste një gjë e tille ... Dhe rralle ngjet edhe sot, kur sheh bij artistesh apo "vipash" qe jo vetëm nuk ngjiten ne ato shkalle ku kane arritur prindërit, por mbesin ne hije, për te mos thënë mediokër.

Familja Smaja është një nder ata rastet e rralla ku breznitë ndjekin njëra-tjetrën. Fatmirësisht, siç thotë ai proverbial shkodrane: *"Ban baba se te ngjas, edhe një pëllëmbë ta pershqas (ta kaloj)"*.

Hasan Smaja, mbetet ne kujtesën e Shkodrës si një nder aktoret me te njohur dhe me te shquar te Estradës Profesionaliste ne teatrin "Migjeni" te Shkodrës. Një



nder themeluesit e kësaj estrade qe u be një nder estradat me te shquara te Shqipërisë, për shfaqjet e saj te bukura me humor aq te prekshëm, madje proverbial qe edhe sot kujtohen me kënaqësi te veçante, qe edhe sot te përfitojnë emocione. Talent i lindur, antifashist e partizan, u dallua për vlerat autoriale qe ne grupet e para artistike me një humor te holle, me një plastike unikale. Hasani ishte partner i denje i atij grupi aktoriat te shkëlqyer, si: Tano Banushi, Zylia Miloti, Paulin Preka, Zef Deda, Bik Pepa, Drane Xhaj, Gjosh

Vasia, Gezim Kruja, Jolanda Shala, Muharrem Nurja e te tjerë, qe e bën estradën e Shkodrës te dashur dhe te ndjekur me devocion nga qindra e mijëra fansa ne te gjithë vendin dhe përtej kufijve. Ishte i gjithanshëm, madje edhe aktor i shquar ne shume drama e komedi, si: "Baca e Gjetjave", "Fundi i një komedie", "Këshilli i ndrikulla" e te tjera. Njeri i mire dhe i dashur, zbulues dhe përkrahës i shume talenteve te reja qe mbushen estradën e Shkodrës. Dhe e "meritonte" plotësisht titullin e larte qe iu dha "Artist i Merituar", bashkëshort dhe prind i devotshëm. Ishte babai i Fatbardhit dhe beri çmos qe ky djalë ta "meritonte" qenien: Bir i një artisti te Madh.

Fatbardhi, apo siç njihet ne Shkodër, **Bardhi**, është sot figura me karizmatike e teatrit "Migjeni", regjisor i talentuar qe ndjek dhe përpiqet te çoje me tej gjurmët qe lanë ne këtë teatër paraardhësit e tij, Lec Shllaku, Andre Skanjeti, Esat Ok-



trova, Serafin Fanko, Elez Kadria, Violeta Sekuj e te tjerë, duke vene me dinjitet ne skene dhjetëra drama e komedi qe i shtojnë vlerat e pamohueshme arkivit te pasur te këtij teatri.

Kane ngelur te pashlyera ne kujtesën e spektatorit pjese te tilla, si: "Ultime lune", "Bjeri për mua violinës", "Surpriza", "Dy jete", "Big Brother ne Shkodër" (fitues ne festivalet mbarenacionale ne Ferizaj dhe Presheve) e te tjera. Kane ngelur gjithashtu te bukura dhe mbresëlënëse interpretimet e Bardhit ne filma te tille si: "Fundi i një gjakmarrjeje", ne rolin kryesor; "Fejesa e Blertës", ne rolin e shoferit aq simpatik e ne te tjera. Virtuoz dhe i mirënjohur si klarinetist, me një humor te holle, i heshtur, por vrojtues dhe parashikues. Bardhi mbetet "voce in capitulo" (zëri kryesor) me mbarëvajtjen e repertorit te teatrit "Migjeni", te cilin po e drejton ne binaret qe te çojnë përsëri ne namin e hershem te këtij Teatri. Tani po përgatit dramën e njohur te Ndreku Luces **"Shtate shaljanet"** si shfaqje jubilar ne 100 vjetorin e Shpalljes se Pavarësisë. Një gjetje e zgjuar e këtij regjisor, për te treguar se preludi heroik i përpjekjeve ne rrugën drejt Pavarësisë nisi ne Shkodër.

Kur mbaroi shkollën e larte te aktrimit, Bardhi u emërua ne teatrin "Migjeni" se bashku me shoqen e vet, Meritën.

Merita, bashkëshortja e denje ne plotekuptimin e fjalës e Bardhit do e behej shume shpejt e njohur si aktore



e shquar dhe me autoritet te plote ne teatrin "Migjeni". Aktore shumeplanesh, tragjike dhe komike. Ajo, sot përpiqet te behet pasardhës e atyre qe shkëlqyen ne teatrin "Migjeni", Tinka Kurti, Vitore Nino, Antoneta Fishta e te tjera. Fitues e çmimit te pare si aktorja me e mire ne Festivalin e 29-te mbarenacional te Ferizajt "Kosove-2011" me rolin e Merit ne dramën "Dy jete". Interpretuese e sukseshme ne dhjetëra drama e komedi ne dy dhjetëvjeçaret e fundit, interpretuese me sukses ne filmin shqiptaro-kanadez "Lettere al vento" (roli Nores) dhe ne rolin e Diles ne filmin "Festa e maleve". Merita provoi me sukses edhe si regjisore duke vene ne skene monodramën e nobelistit Dario Fo "Seks, faleminderit ... sa me e provue". Aktorja e njohur Rita Gjeka ne këtë monodrame fitoi çmimin e pare, si aktorja me e mire ne festivalin prestigjioz ndërnacional te aktrimit ne Fier "Apolon-2012".

Merita Smaja është bere shume e njohur edhe si person publik ne Shkodër, si "Show Mene" me e shquar e qytetit, dre-



jtuese emisionesh te sukseshme artistike, "kripa" e shume aktivitetesh lokale dhe nacionale, e dashur dhe e respektuar nga mijëra shikues e dëgjues te këtyre emisioneve dhe aktivitetesh te sukseshme.

Sara e Fisniku, janë dy bijtë, vajza e djali i Bardhit dhe e Meritës.

Sara, vitin qe shkoj mbaroi shkollën e larte te Aktrimit dhe u emërua ne teatrin "Migjeni", duke interpretuar krah prindërve te saj, ballëhapur dhe denjësisht. Këtë e provoi qe ne aktivizimin e saj te pare ne dramën "Dy jete". Aktore e re qe i mungonte këtij teatri. Sara po përgatitet te marre dhe Masterin si aktore, duke u bere kështu e para aktore me master ne teatrin "Migjeni". Tani se fundi është angazhuar edhe ne një film te regjisorit Fatmir Koçi. Pra, një fillim i mbare dhe premtues për Saren.

Fisniku, filloi sivjet fakultetin për regji filmi.

Sara e Fisniku janë breznia e trete e dinastisë artistike Smaja. Fillimin e kane te mbare dhe unë jam i sigurte se do te jene trashëgues te denje te prindërve te tyre. Unë, i uroj Sares qe nesër te behet



si Sara Bernad (aktore e famshme e teatrit francez), ndërsa Fisnikut i uroj qe te behet i denje i "Fisit artistik Smaja"!

Nga Mjeshtri **Fadil Kraja**

VENDIM I KRERËVE TË DUKAGJINIT I VITIT 1937

Mbledhja filloi nën kryesinë e të deleguesit të shkëlqesisë së tij Ipeshkvit të Dukagjinit Benardin Shllaku, Padër Rrok Gurashi, Zv.Nënprofektit Kapiten Z.Shaban Elezi:tuj pranue si sekretar Z.Asim Bekasin:

- Mas një diskutimi të gjatë mbledhja unanimisht pranoi e vendosi pikat e poshtshueme:

1- **Festat me miq** janë krejt të ndalume në çdo fshat e krahine me përjash-tim të bijave që vinë me fëmijë dhe atyret që kanë pasur një nevojë të domosdoshme dhe kjo e vertetueme me dëshminë e pleqnisë me shkrim dhe të jetë vërtetu dhe prej Postë Komandës së Vendit.

2- **Në gjamë** (në rast vdekjesh) do të marrin pjesë nga një për shtëpi prej asaj lagje të

cilët kanë me pasun të drejtë me hangër vetëm një herë, një drekë në atë shtëpi, në gjamëkanë me marrun pjesë vetëm miqtë e ngushtë jashtë bajrakut e të bajraqeve të ndryshëm, kukëta mbasi janë të largët, kanë me pasun të drejtë darkën e të sillën të nesërmen.Me këtë rast i zoti i shtëpisë ndalon dhjetë shokë prej mahalle për me hangër darkëdhe me ju ba hyzmet të ardhurve prej bajrakëve të jashtëm, për këtë rast edhe miqtë engushtë të katundit Theth në Shalë e Shala në Theth dhe Prekali në Shosh e Shoshi nëPrekal, kanë të drejtë vetëm me hanger një darkë, të nesërmen pasi të kenë hanger të sillëshpërdahen secili në punën e tij.

I vdekuri deri në aksham ashtë e detyrueme të varrosët në varre, dhe mbasi të shpërdahet krejt miqësia, ashtë e ndalume me u ba gjamë ose me nxjerrë teshat e të dekunit.Me një fjalë krejt drekët ndalohen. Në gjamë ashtë e ndalume sheqeri edhe rakia. d.m.th në këto raste nuk nxjerrë kafe me sheqer e me raki

3- **Kundravajtsit e pikës 1 dhe 2 të paragrafit të masipërm denohen nga 20 fr ari deri në 100 fr, simbas ligjës së administratës civile.**

4-**Vazjat** mbas datës së sotme nuk lejohet të **fejohen** pa mbushë moshën 15 vjeç.

a-Vajza në rastin e fejesës do të pytet prej prindes saj dhe mbasi të ketë dhanë pëlqimine saj ka me u fejumun me këtë burrë të caktuam. Mbas kësaj vajza ashtë rreptësisht e ndalumeme ikë prej shtëpisë e me shkue te një burrë tjetër, por edhe anasjelltas nuk mundën me imbushun mendjen vajzës, për me shkue e me marrë një tjetër burrë, as përdhunshëm nukmunden me ba një vepër të ktilë, por edhe

nji burrë që pranon në shtëpinë e tij ose tjetërkund një vajzë e cila ashtë e fejume me një burrë tjetër ashtë i ndaluem rreptësisht

b- Në rast se ndodhë një vepër e këtillë, paria dhe pleqësia tuj pas edhe ndihmën e administratës e marrin vajzën me forcë dhe e dergojnë në shtëpinë e prindës pa asnji kundërshtim

5- **Vazjat e martueme** para datës së sotme, do të martohen me atë burrë që ashtë fejueme ma parë, pa asnji kundërshtim dhe për ato që nuk bindën kanë me veprue si mbas pikës 4, paragrafit B.

6- **Sheji i fejesës** (Kapari) u caktua maksimumi **franga ari një**.

7-**Për pajë të vajzës** që ka me pague dhandri, nuses u caktua 1-12 napolana si mbas zotësisë ekonomike të dy palëve miq.

a- **Të hollat** që jepëm për pajën e vajzës nuk do të përdorën, për ndonjë send tjetër vetëmse për pajë të saj. Paja, ka me u ba sikurse ka këndë ra dakord mes dy palëve. Pos këtyre të hollave që merr për pajë nusja tjetër gja nuk mund të kërkojë prej prindërve të dhëndrit.

b- Në rast se shkojnë dasmorët me marrun nusen, prej dhëndrit kanë me i dergje vetëm një fërluk dhe fr ari 5 dhe nuk kanë me i dergue asnji send tjetër. Si mbas zakonit tëfejesës me të sipërpërmendurat ashtë plotësue Feja e nuses.

c- Deri në mbarim të këtij viti kanë me u martue vajzat, sikur e kanë pasun zakonit ma përpara, tuj i dhanë veç pajës që ashtë caktue me gjithë atë të Fejesës se nuses e të tjera.

8- **Po vdiq vajza** përpara martesës shek (kapari) nuk kthehet:

a-Në rastise vdes vajza e fejume, paret që mund të ketë marrun deri në atë kohë prej dhandrit, gjindja e vajzës janë të detyrueme me ja kthye shtëpisë së dhandrit gjysmën e pareve që ka marrun.

b-Në rast se vdes dhandri pa u martue, prindja e vajzës janë të detyrueme me i kthye shtëpisë së dhandrit të gjitha paret dhe kaparin që ka marrë deri në atë kohë, mbas kësajvajza ashtë e lirë me u martue ku të duen. Shtëpia e dhandrit nuk mundet në asnjë mënyrëme pengue vajzën për mos me u martue, ose me detyrueme marrun një tjetër në atë shtëpime përjash-tim se kur do t'ju pëlqejë të dy palëve dhe tuj respektue pikën 4 paragrafin A.

Kjo pikë vlen për të gjitha vajzat që janë fejueme përpara kësaj date.

c- Kur vdes burri i martuam dhe len

gruen vejë, kjo ashtë e lirë me u martue ku të donë dhe shtëpia e burrit nuk mundet me i nxjerrë kurr një pengesë.

Në rast se kjo grue largohet prej shtëpisë së burrit ka të drejtë me marrë të gjithë pajën që ka sjellë me veti dhe ato tesha që ja ka ble burri ose shtëpia e burrit me pëlqimin të gruas së ve dhe në rast se i del kunora zyrtarisht mundet prap me u martue në atë shtëpi, por në rast se martohet tjetër kund gruaja e ve ashtë e detyrume me i dhanë gjysmën e pareve shtëpisë së burrit të parë, që ka me marrë prej martesës së dytë

ç- Grueja e ve mbas dekës së burrit e që dom me u martue, për deri që të martohet do të rrinë në shtëpinë e prindës e jo në një shtëpi tjetër. Gratë e veja që kanë fëmijë e nuk don me u martue do të rrinë në shtëpinë e në hise të burrit.

9- **Ndalohet rreptësisht me mbajtë kush në shtëpi grue pa kunorë.**

- Çdo grue e ve që ashtë pa kunorë në një shtëpi, menjëherë me anë të parisë e të pleqnisë e tuj pasun ndihmën administrative e qesin jashtë këtë grue dhe e dergojnë nështëpinë e prindës të asaj, për sa edhe prindrit e vajzës nuk guxojnë në asnjë mënyrë me ilanë vajzat në këtë mënyrë

10- **Dasmat** kanë me u ba vetëm një natë e një ditë dhe këtu mund të marrin pjesë vetëm të afërmit e miqtë e ngushtë që kanë me u thirrë si në shtëpinë e dhandrit dhe të nuses. Të jashtmit nuk do të marrin pjesë as nuk do të kërkojnë që të jenë të thirrur në dasëm.

11- **Kundravajtësit e pikës 4 deri në pikën 10 të këtij vendimi kanë me u gjobitë prej 20-100 fr ari, si mbas ligjës së administratës civile.**

12- **Në famuj** nuk do të shkojnë tjetër kush veç kumbara vet i tretë.

- Shtëpia e famullit mund të thërrasë në këtë gosti vetëm deri në 7 vetë shokë.

- Kumbara do t'i falin famullit vetëm 30 lek

- Ndrikulla ka me i falë kumbarës një palë shputë

- Nji palë çorap

- Nji këmishë

-Nji kapuç dhe një faculetë

-Shokëve që ka marrë kumbara me veti u falë nga një palë çorapë

- Kumbarët nuk kanë të drejtë me shkue në asnjë shtëpi tjetër veç se te ndrikulla

- Në këtë rast ashtë e ndalume me u pre berre.

13. **Buka dhe përgimi** (rast lindjesh) ashtë e ndalume.

14. **Lamja e duerve** e tasit dhe ibrikut të rakisë grihet fare ky zakon e nuk mundet kush prej të thirrurve me kërkue pari, si me tanë për Bajrakë, Katunde, Lagje, ose Fise sikur kanë këndë ma përpara zakonit, porse kjo vepër si për radhën e lamjes së duerve edhe tetaseve dhe të ibrikut të rakisë i lihët me u rregullue zoti shtëpisë, dhe ibrikun i zoti shtëpisë ka me ua lanë shokve të mahallës të cilët bajnë hyzmet në këtë tervesë.

15. **Rrahja ashtë e ndalume.**

- Ai që guxon me vu dorë mbi shoqin si me e vra e me fjalë, rrahësi ka me u përjashtue,

a- Prej çdo mbledhje

b- Prej çdo bashkimi

c Ashtë e ndalume me i dhanë kush bukë dhe me përcjellë në rast se ka frikë.

ç- Ashtë e ndalume me marrun pjesë në çdo dasëm ose morte.

d- Askush nuk mundet me ja hanger bukën as në dasma as në morte, që në këtë mënyrë mbetet ma i fyem se i damtuemi, për se në anën tjetër do të i lutemi qeverisë përme internime këtë.

16. **Mbas tashti** ashtë e ndalume me shetitë shtëpi më shtëpi pa shkak tuj ndej pa punë, si me tanë se ish ba zakon me vizitu kohë e pa kohë te njani tjetri dhe për të këtillë përsone do ti lutem qeverisë me i shti në punë publike.

17. **Për kundra vepruesit** e pikës 12 deri në pikën 14, denohen me gjobë nga 20 -100 fr ari, si mbas ligjës së administratës civile.

18. Ky vendim ashtë i zabatushëm, mbasi të jetë aprovue prej qeverisë dhe të jetë shpallë në fletorën zyrtare të vëndit të Profekturës së Shkodrës,

Dukagjin me 24. 10. 1937

Kolë Ndou, DV, Lulash Gjeloşi, P. Rrok. Gurashi, Mark Delia, Solol Marashi, Vuksan Leka, Mark Sadiku, Prenush Dashi, Mark Kola, Can Bashota, Kol Marash Zefi, NdokëÇuçi, Ndue Marash Kola, Dedë Preka, Sokol Nika, Ndoc Palë, Pal Dedushi, Gjon Prela, Zef Marashi, MarashNdou, Çuk Gjeloşi, Kolë Vata, Dedë Gjeloşi, Mirash Gjoni, Mark Ndou, Mark Delia, Kolë Prela, Gjergj Sokoli, Vatë Sokoli, Stak Pjetra, Ndokë Nika, Pjetër Marashi, Mirash Mdou, Prekë Marashi, Mhill Vata, Shytan Nika, Mark Pepa, Gjeloşi Nika, Mhill Ndou.

Sekertari i mbledhjes **Asim Bakesi**

Nga Prele Mlani, botuar sipas origjinalit te AQSH. F374. D NR2 viti 1937 librrit "Shoshi", bot 2011, 437 fq.

Kur mungon dashuria e nënës

Për ata që nuk i dinë pasojat e mungesës së dashurisë së nënës tek femija, që nga momenti i lindjes, është shumë e vështirë që ti imagjinojnë ato. Femia, që nga momenti që shkeputet nga barku i nënës, pushtohet nga ndjenja e frikës dhe e pasigurisë. Askujt tjetër nuk mund tja besojë ai sigurinë e tij veçse nënës së vet. Nevojat themelore të tij janë kontakti trupor, perkushtimi shpirtëror, ndjenja e mirëseardhjes dhe e sigurisë. Këto përbejnë bazamentin mbi të cilin femija do

të ndërtojë personalitetin e tij të arthshëm. Veçanërisht në vitin e parë të jetës së tij femija është shumë i lidhur me nënën dhe shumë i influencuar nga dashuria e saj. Ata që nuk e perjetojnë këtë në këtë fazë, do të vuajnë gjithëjetën. Femia bebe, kur shikon shkelqimin e syve të nënës,ndjehet i sigurtë, i lumtur dhe i qetë.

Psikologjia e zhvillimit percakton etapat në të cilat kalon një zhvillim psikik i shendosh tek njeriu. Djegia ose kapercimi i tyre, shkaktojnë tek personaliteti i arthshëm

i ndividit pasoja nga më të ndryshmet. Dhe këto etapa fillojnë që nga momenti i shkeputjes së femijës nga barku i nënës. Në këtë fazë, femija duhet ta ndjejë veten, ashtu si më parë në barkun e nënës, një person me nënën. Në kulturën e rritjes së femijëve të disa popujve, nënat i mbajnë bebë në kurriz, kështu që qumështthithësi e ndjen veten një trup me nënën. E shprehur kjo në gjuhën profesionale, quhet simbiozë (dy gjallesa në një trup). Pashkëputshmëria fizike e bebëit nga nëna është siguria më e

madhe jetike për atë. Për zhvillimin fizik të femijës duhen ushqim,ngrohtësi dhe hygjienë. Për zhvillimin shpirtëror i duhen dashamirësi dhe kontakt lëkurorë (fizik) nëpërmjet ferkimeve. Ai don që ta ndjejë, nuhasë dhe shijojë nënën e vet. Fillimisht femia është në gjendje vetëm sa të mund të bëjë dallimin midis kënaqësisë dhe pakënaqësisë. Kënaqësinë ai e merr nëpërmjet të thithurit të gjirit të nënës dhe perkëdheljeve të saj. Pakënaqësinë ai e ndjen nga ndjenja e urisë,dhimbjet dhe ndjenja e braktisjes nga nëna apo personat e tjerë që mund ta shoqerojnë atë. Në raste të tilla, shumë bebe reagojnë në mënyrë agresive, me qarje të forta deri në

THETHI – MIKPITËS I PAKUFISHËM

BASHKËBISEDIM ME SHEMBULLORIN PËLLUMB LULASHI

Pëllumb Lulashi tash është në të tetëdhjetat, po mbahet shumë mirë, pothuaj nuk ka ndryshuar që nga mosha e rinisë për nga pamja e jashtme. Pavarësisht se mosha bën të vetën, ka po atë të folur, atë buzëqeshje, atë dashamirësi, me një arsytim dhe saktësi për tu pasur zili.

Pëllmub Lulashi është njeri me tipare të plota malësori, i gjatë, i shkathët, energjik, dashamirës në bisedë, gojë ëmbël, pjesëmarrës në gëzime dhe hidhërime pa mungesa të bashkë fshatarët, miqtë dhe të njohurit e tij.

Nuk është e lehtë të shkruash për njerëz të tillë që kanë vlera të spikatura e gjithnjë kanë qenë në lëvizje, sa në një zonë në një tjetër.

Pëllumb Lulashi u lind më 13 maj 1933, në një familje me tradita shumë të mira morale, shoqërore dhe atdhetare në fshatin Lekaj të Shalës, në Dukagjin. Në moshën 19 vjeçare fillon punën në frontin e edukimit si mësues në fshatin Theth. Në ato vite bëhej një punë shumë e madhe, kujton Pëllumbi, për luftën kundër analfabetizmit duke hapur kurse për të rriturit në çdo fshat apo lagje fshati në të gjithë Dukagjinin. Nga ana tjetër filluan të shtriheshin shkollat që në atë kohë quheshin shkolla fillore në të gjithë zonën. Për 10 vjet, pra deri në vitin 1962, Pëllumbi punoi në detyrën e mësuesit edhe në shkolla të tjera, sipas nevojave të kohës, si, në Kasnec të Kirit, Nicaj-Shosh, Brashtë, Abat dhe Ndërlës.

Në vitin 1962 ndryshon punë dhe kalon në Ndërmarrjen e grumbullimit me qendër në Theth me detyrën e llogaritarit dhe pak më vonë në atë të teknikut-specialist për grumbullimin e mishit, leshit, lëkurëve, bimëve mjekësore, aromatike e industriale. Për një periudhë mjaft të gjatë në Theth ishte qendra e shpërndarjes së drithërave të bukës për banorët që nuk përbaltonin nevojat me prodhimet e tyre për bukë. Në këtë ndërmarrje punon plot 31 vjet pa ndërprerje. Puna për grumbullimin e prodhimeve që tregtonin fshatarët ishte e shtrire në të gjithë Qarkun e Shkodrës të asaj kohe, prandaj Pëllumbi ishte gjithmonë në lëvizje, sa në një zonë sa në një tjetër, sa në një kooperativë sa në një tjetër. Kishte një sistem të tillë të organizimit të punës që nuk pengohej asnjëherë. Prodhimet që dërgoheshin nga Pëllumbi magazinoheshin me korrektësi nga magazinierët në qendrën e grumbullimit. Nga puna e kujdesshme e Pëllumbit nuk pati asnjëherë pakënaqësi apo paqartësi as nga magazinierët as nga fshatarët që shisnin mallin.

Kudo që e takojë Pëllumbin, në dimër apo verë, në ditë me shi, apo me diell, gjithmonë mbante çadrën me vete. E varte në jakën e

xhakëtës pothuaj vazhdimisht. Kur e pyesnin se pse e merrte edhe në ditët e mira, ai thoshte se jam në lëvizje, sot jam këtu, nesër duhet të shkoj në një fshat tjetër e moti mund të ndryshojë, e duke qeshur, thoshte me shaka se çadra ka thënë "kush nuk më merr për ditët është e mira, nuk ja dijë për ndër kur më merr në ditët me shi."

Duke u interesuar për llojshmërinë, cilësinë dhe sasinë e listës së grumbullimeve, Pëllumbi sqaron se nga malësorët nuk njiheshin vetëm çaja e malit që quhet rigoni i kuq dhe çaja e egër që quhej teukël. Na është ngarkuar detyra edhe për seminarët me popullin, në



veçanti me fëmijët për tu bërë të njohur atyre llojet, mënyrën e grumbullimit dhe tharjes, ruajtjes, transportit dhe dorëzimit të tyre. Shitja bëhej më lehtë në dorë. Jo radhë kishte edhe ndërhyrje nga drejtuesit e kooperativave bujqësore për të penguar punën, me argumentin se krahët e punës largoheshin nga puna për tu marrë më bimët e ndryshme që grumbullonim. Ai nxjerr nga xhepi një bllok të vogël, pasi unë i kisha thënë se përse dëshiroja që të takoheshim, dhe qete-qetë tregon një listë të gjatë sipas grupeve që grumbulloheshin në atë kohë. Në çdo vit grumbullohen rreth 10 000 kv mish nga oborret private të fshatarëve në të gjithë Malësinë e Mbishkodrës.

Pastaj më tregon sipas grupeve, grupi i luleve: lule bliri, agulice, verbaskum, thundërmushkë, shqerre, tradafil i egër, murrizi me fletë, murrizi pa fletë, shtogu, kulumbr, lulëkuqe, mëllagë, 1 000 fletësh, çikore.

Grupi i fletëve: fletë luleshtrydhe, thundërmushkë, mëllagë, mëllagë e bardhë, mjedre,

boronice, balsam, hithre, arre, lajthie, frashri, delli badhganë, delli badhngushtë, shqemë.

Bimë komplet: Bima 1 000 fletësh, balsam, teukël, rigon i kuq, milcë, çaj i jugut, çikore, kinfushe, zhumbriçë, myshqe pishe, myshqe lisi, kalaminta.

Në grupin e rrënjëve grumbullonim: rrënjë sanze, shpatore e qëruar, shpatore e paqëruar, fieri i egër, shtare, hithre, belladoni, tuber salepi.

Fruta, fara dhe lëvore: farë xhërrrokulli, kokërr trëndafil i egër, boronice, murrizi, kulumbrie, shelgu, dëllinjë e kuqe, dëllinjë e zezë, lëvore drunakuqi (arçi).

Pasi e pyes për sasinë që grumbullohej brenda një viti, ai tregon se afërsisht ishte kjo sasi: lule të të gjitha llojeve gjithsejtë rreth 450 kv, fletë 650 kv, herba 750 kv, rrënjë 850 kv, fara, fruta dhe lëvore 250 kv.

Grumbullonim edhe gjallesa si Bretkosa 50 kv, dhe Kërmij 250 kv. Është e rëndësishme të tregojmë, thotë Pëllumbi, se çdo vit grumbullohej, vetëm në Shalë, mbi 6000 kv shqemë që dërgohej drejt e në fabrikën e ekstranimit në Vlorë dhe që përdorej për regjinë e lëkurëve. Ishte një periudhë shumë e ngarkuar e vitit sepse në këtë drejtim punohet vetëm në verë, sepse atëherë e ka kohën e përshtatshme, por në këtë kohë ishte edhe vala e punës në bujqësi dhe për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë. Në detyroheshim të ngrinin qendra të grumbullimit të shqemes në shumë pika, të organizonim transportin dhe të kontrollonim cilësinë e saj, pasi mund të dëmtohej lehtë veçanërisht nga lagështira, ose mos tharja në kushte të mira. E gjithë shqema kalonte nëpërmes qendrës tonë të grumbullimit. Kjo nuk ishte punë e lehtë, por duhej bërë, sepse koha ishte e tillë që duhej realizuar plani ose dilnin probleme jo të lehta ligjore e politike.

Në qendrën tonë të grumbullimit, si edhe në qendrat e tjera, grumbulloheshin edhe lëkurë të kafshëve të egra si: Lëkurë shqarri grykëbardhë deri 100 copë në vit, shqarri grykëkuq deri 80-90 copë, dhelpër deri 1 500 copë, lepur i egër me shumicë, vjedulle, lundërze, ujku, çakalli, geri, ketri, riqebulli. Riqebulli është zënë për herë të fundit në vitin 1982. Rreth 10 vjet më parë është zënë edhe një tjetër ofër Qafës së Valbonës. Është zënë edhe micë e egër që ka trupin më të madh se mica e zakonshme, me disa vija të lehta në ngjyrë të kuqe të ertë e cila është zënë në dimrin e vitit 1983, afër Varrit të T'riepshit. Bëhej shumë kujdes, thekson Pëllumbi që gjuetia e kafshëve të egra bëhej në sezonin kur nuk janë në sezonin e riprodhim. Janë grumbulluar edhe lëkurë të kafshëve shtëpiake si deleje, dhie, keci qengji, viçi dhe gjellësh.

Duhet me thënë, thotë Pëllumbi, se kishim një plan që duhej bërë çmos për ta reali-

zuar. Ai plan kishte dy qëllime: së pari, për të ndihmuar në plotësimin e nevojave të popullit, së dyti, veçanërisht në grumbullimin e bimëve medicinave, aromatike e industriale, bëhej një farë planifikimi për ruajtjen e tyre. Kur mbyllej plani nuk pranoni të tjera sepse duheshin ruajt që të mos shfaroseshin dhe të mund të shfrytëzoheshin në vitet e tjera. Ndodhte që për disa vite të mos pranohej grumbullim i disa llojeve në një territor të caktuar. Edhe për kafshët e egra bëheshin përpjekje për ti ruajtur. Kemi pasur raste, tregon Pëllumbi që kemi grumbulluar edhe lëkurë të kafshëve që nuk lejoheshin për tu vrarë, por këto ishin rastësi apo aksidente, sepse ziheshin në çark ose tela që ishin vendosur për kafshë të tjera.

Kujtoj me shumë respekt bashkëpunëtorët me të cilët kam punuar në vite si të ndjerin Llesh Sokoli, një burrë i nderuar në të gjitha drejtimet, Kolë Marku i kujdesshëm dhe shumë i disiplinuar, të ndjerin Zef Gjergji energjik në punë, të ndjerin Ndue Pali punëtor, i lidhur edhe me drejtimin e pushtetit në fshat, të ndjerin Vuksan Marku kurdoherë i gatshëm, mikpritës që shtëpinë e tij nuk e gjeje asnjë herë pa miq, dimër as verë, natën as ditën, por kujtoj me shumë respekt edhe Martin Pjetri e Tomë Martini në Kelmend, Lekë Pjetri në Hot, e te tjere. Ju kërkoi falje, thotë Pëllumbi që nuk po përmendë të tjerë, por më të gjithë sa kam punuar jam nda shumë mirë gjithmonë dhe ruaj respektim më të madh.

Vjen një moment dhe Pëllumbi ndërpret bisedën dhe mendohet për pak çaste dhe pastaj më thotë me një ton të thellë, sikur fjalët nuk po i fliste goja por vetë zemra. Do të të them diçka, që nuk e harroj kurrë, por u duhet thënë edhe brezit të ri dhe atyre që vinë. Unë kam punuar dhe jetuar me qendër në Theth për 33 vjet. Kam pasur të bëj me njerëz, që vinin nga Tropoja, Malësia e Madhe, gjithë Dukagjinin dhe më gjerë. Kam parë njerëz që mbetnin deri vonë pa mbaruar punë, sepse ishin shumë, i zinte edhe nata e nuk kishin mundësi për tu kthyer në shtëpi. Të gjithë gjenin strehë pa asnjë vështirësi në shtëpitë e thethjanëve, e unë do të quaj çdo shtëpi thethjani hotel dhe restorant pa para për mikun, rugëtarin, shtegtarin e kalimtarin e rastit, me bujari, respekt e buzëqeshje e edhe të nesërmen duke i dhënë bukë me veti atyre që e kishin rrugën e gjatë. Thethi-qendër e mikpritjes së pakufishme, mund të thuhet pa asnjë mëdyshje thotë në mënyrë të vendosur Pëllumbi. Kjo ka shumë rëndësi për mua që ta them, vazhdon ai, sepse them një të vërtetë të madhe, e këtë nuk e kam parë vetëm unë por çdo kush që ka qenë në Theth.

Nga Luigi Shyti

nxirje të fytyrës dhe trupit. Gradualisht, femia duke u rritur, fillon shkeputjen fizike nga nëna por, jo nga prania e asaj. Sidomos kur ndjehet i frikësuar kthet menjëherë tek ajo. Nëna duhet që vazhdimisht ti japë atij sigurinë se i ndodhet pranë, me qëllim që femija të shtojë distancën e rrugës të eksploruarit. Kështu femija ndjehet i sigurt dhe vihet vazhdimisht dhe gjithënjë e më shumë në kerkim të vetvetes, në mënyrë të pavarur. Për aq kohë sa femija nuk ka krijuar akoma "Unin" e vet, jeton me atë të nënës. Në këtë fazë ai mendon: Dritani i vuri lodrat në vendin e vet. Me këtë ai mendon vetveten. Kur ai fillon të mendojë se: Unë i vura lodrat në vendin e vet, do të thotë se ai ka filluar të formojë identitetin e vet pra, ta njohë vetveten i pavarur nga nëna.

Sipas specialistëve, shqetsimet e personalitetit të njeriut, fillojnë në fazën e femijërisë së hershme, atë të qumështthithjes. Nëse femija nuk perjeton fenomenin e sim-

biozës, pra, nëse nëna, në vend të ndjenjës së sigurisë i tregon atij atë të pasigurisë dhe trishtimit, ai mbetet me ndjenjën e vet të frikës dhe pasigurisë. Sipas traditës shqiptare, i indja e djalit është gëzimi i shtëpisë dhe e vajzës merzija, trishtimi. Në shumë familje, këtë trishtim vajzat do ta vuanë gjithë jetën e tyre. Ato do të trajtohen si dorë e dytë dhe e tretë në familje. Nuk perjetojnë dashurinë prinderore dhe do të trajtohen me ato që teprojnë. Nëse tepron gjë. Mungesa e furnizimit me dashuri dhe dashamirësi, e perkëdheljeve, e urimit të mirëseardhjes nga shkelqimi i syve të nënës, e perkujdesjes se perhershme, në rradhë të parë dhe mbi të gjitha, shkakton ndjenjën e frikës e cila do të bëhet ndjenja dominante tek femija, për gjatë gjithë jetës së tij. Edhe nëse ai dikur do të mund ta mposhtë disi këtë frikë në aparcën e jashtme, kjo nuk do të thotë se ai e ka mposhtur frikën. Në nënvetëdijen e tij ajo jeton dhe kërkon gjithënjë që me dhunë të

dalë në sipërfaqe. Kjo ndjenjë çliron energji negative shperthyes, energji e cila drejtohet kundër vet personit ose, nga ai tek dikush tjetër. Ai nuk e krijon dot ekuilibrin e brëndshëm dhe vuan nga mungesa e stabilitetit. Të gjitha fazat e tjera të zhvillimit të personalitetit të njeriut ndikohen fuqishëm nga ajo e femijërisë së hershme. Në fazën e pubertetit femija fillon të përjetojë identitetin e vet duke ja kundërvënë atë prinderve dhe edukatorve. Ai mundohet ti mposhtë ata, duke i menduar si pengesa në realizimin e dëshirave të veta (Nëse do të mund ta mposhti nënën, atëherë nuk do ta humbi atë). Me këtë motiv ata mundohen që të sillen me cilindo. Femijë të braktisur nga dashuria prindërore, në të shumtën e rasteve janë agresiv (brutal) ose depresiv. Rast pas rasti, ata mund ta orientojnë agresivitetin e tyre ndaj vetvetes ose, jshhtë vetvetes, ndaj të tjerëve. Ata që agresionin e drejtojnë ndaj vetvetes, janë ata që ne i mendojmë kokëfortë, të pabindur, dhe që i bien murit

me kokë. Janë superaktivë, të paorientuar dhe të pallogaritshëm. Ndjenja e frikës se do të keqtrajtohen apo rrihen dhe zduken nga të tjerët, i bën ata shume brutalë dhe të dhunshëm në sjelljet me të tjerët. Për të mposhtur ndjenjën e frikës ata janë gjithënjë në aksione të dhunshme, menderisht dhe fizikisht. Ata krijojnë vështirësi kudo dhe me cilindo që do të ken të bëjnë, në familje, kopësht, shkollë, punë dhe kudo. Edhe me natyrën dhe gjallesat e saj.

Shoqeria njerzore, mund të prodhojë çdo gjë por jo njerz. Ajo i merr ata nga prehërat e nënave. Se si do të jetë shoqeria e jonë, kjo do të varet shumë nga prodhimi njerzor i nënave. Qytetrimi i nacionalitet është fshehur në qumshtin e nënave. Sipas Freudit, mardhenjet e hershme prinder femijë, janë ato që do të përcaktojnë se kush do të jetë femija kur të rritet ... Pa represion dhe sublimim nuk mund të ketë civilizim.

Nga Lekë Imeraj
shkrimtar dhe perkthyes

Në thellësitë e shpellës së ÇOKUT ... !?

- Reportazh -

Ka kohë që shoqata "Atdhetare-Dukagjini" është bërë promovuesja më e madhe e vlerave turistike, kulturore, historike të kësaj zone. Ajo tashmë i ka anëtarët dhe aktivistët e saj në të gjitha vendet e botës, në spektrin e veprimtarive të saj mbulohen të gjitha fushat e jetës.

Prej disa muajsh ishte planifikuar që në verën e sivjetme të bëhej një vizitë në Shpellën e Çokut, në bjeshkët e fshatit Kirë.

Mungesa e mjeteve të domosdoshme të sigurta nga njëra anë dhe frika ana tjetër, kanë penguar eksplorimin e kësaj shpelle nga banorët e fshatit, që në vitet e hershme gjatë shekullit XIX kjo shpellë në hyrje të saj është përdorur si mbrojtje natyrore për t'u

strehuar banorët e këtij fshati nga armiqët e ndryshëm e në veçanti nga Serbët e Malazezët në vitin 1915, por edhe në raste të tjera.

Vazhdimisht, banorët e fshatit Kirë përpqeshin për të shuar kureshtjen duke u futur sadopak në këtë shpellë interesante dhe shumë enigmatike për ta, me mjete rrethore si pishë ose ndriçim me vaj guri, por detyroheshin të ktheheshin fare afër hyrjes.

Në vitin 1970 dy banorë të fshatit Kirë, Nikolla Brigja dhe Gjergj Kroj me një elektrik dore të thjeshtë u futën rreth një orë në shpellë, pasi dolën, kishin argumentuar se është një shpellë shumë e madhe dhe e thellë. Këtë pohim e ka përcjellë edhe gojëdhëna popullore, prej të cilës vijnë shumë thënie interesante.

Mëngjesin e datës 6 gushti të këtij viti, një grup me anëtarë dhe aktivistë të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", pasi i kishim marrë të gjitha masat e nevojshme organizative, u nisëm për ta vizituar, por edhe për të eksploruar diçka nga misteret e kësaj shpelle.

Punën më të madhe e kishte bërë Prel Kroj, banor i fshatit Kirë, ai ishte kujdesur për udhëtimin, akomodimin, rrugën e lëvizjes, të pushimit dhe të kthimit. Për hartat, busullën orientuese, gjatë lëvizjes, por edhe për karakterin zyrtar të ekspeditës ishte preokupuar vetë Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj.

Mjetet e ndriçimit dhe të sinjalistikës për udhëtimin dhe lëvizjen në shpellë i kishte siguruar, Aleks Dushi. Dy djem të rinj dhe të shkathët, të palodhur dhe të pafjalë, Gjon Kroj dhe Arben Rroku ishin siguria jonë në këtë udhëtim që kaloi me pak lodhje, por shumë bukur.

Mua nuk më mbetej asgjë tjetër vetëm ta shijoj sa më mirë këtë rast të veçantë duke fiksuar me aparatit fotografik dhe me kamerë çdo detaj të këtij udhëtimi. Deri në Prekal arritëm pothuajse pa zbardhur dita, dhe kur dielli puthi majat e maleve mbi fshatin Khan, ne kishim arritur në Kirë. Kafën e mëngjesit, kuptohet me raki, e pimë në oborrin e shtëpisë së Gjergj Tomës, i cili gjatë muajve të verës banon atje. Unë dhe Aleks tashmë e kishim filluar punën, dhjetëra shkrepje të aparatit, me detaje dhe momente të jetës në malësi.

Pasi ecëm rreth dy orë në këmbë, nëpër një rrugë jo krejt të lehtë, që shumë pak ishte shkelur këto vitet e fundit, rreth orës dhjetë ishim në derën e Shpellës së Çokut, në bjeshkët e fshatit KIR, ne jugperëndim të malit të Shelnes (lartësia 1 394. 4 m), në lartësinë mbi nivelin e detit rreth 1 300 m.

Vetëm ata që e kanë provuar të udhetojnë nëpër male, vetëm ata që e

kanë përjetuar një eksperiencë të tillë mund ta kuptojnë se sa bukur ishte ta hash mëngjesin në derën e kësaj shpelle. Nga aty pothuajse të gjitha fshatrat e Pultit dukeshin si në pëllëmbë të

dorës, gjelbërimi të bënte që syri të ngopej me një bukuri të veçantë, cicërima e zogjve bënte që të kishe me shumë oreks, ndërsa fresku që frynte nga dera e shpellës bënte që të kërkoje për një xhup

kthim.

Faqet anësore të shpellës kishin marrë forma mjaft interesante, ndërsa pjesa e poshtme ku duhej të ecnim kishte gjurmë rëre, llumi, dhe në disa vende edhe lagështirë që tregonte se në muajt e dimrit shpella mbushej me ujë.

Nuk kishte stalaktite shumë të gjatë, mendoj se kjo ngaqë rrjedha e ujit gjate viteve i dëmtonte ato, por në vendet ku shpella kishte lartësi të madhe ne i gjetëm disa dhe nuk u kthyem duarbosh ... !!! Pasi ecëm rreth një kilometër i gjithë grupi prej 6 vetash, ndalëm për një pushim, kishim bërë shume foto, kishim bërë shume humor, kishim provuar shume emocione, por kuptohet edhe ishim lodhur.

Profesor Aleks dhe dy djemtë e ri Gjoni dhe Arbeni ishin kurioz që të gjenin rrjedhën e ujit që nuk duhej të ishte larg, por Ne "veteranët" nuk ishim te këtij mendimi! Për ne tashmë misioni kishte kryer, pasi bëmë një marrëveshje për kohën që ata duhet të rrinin brenda, unë, Kryetari dhe Prela u kthyem.

Brenda temperaturat ishin shumë të ulta, ndërsa kur dolëm tek dera e shpellës, na priste një i nxehtë përvëlues.

Dy orë pas nesh dolën edhe të tjerët, ata kishin të drejtë të "mburreshin", kishin shkuar deri tek uji, kishin gjetur shumë stalaktite dhe kishin bërë foto interesante!

Nuk ka dyshim që ishin lodhur, pas një udhëtimi mbi 4 orë në thellësi të shpellës, por jam i bindur se kanë shkuar aty ku askush më parë nuk ka shkuar.

Shpella afërsisht është e gjatë rreth 1 415 m. Nga ujerat e kësaj shpelle dalin 7 gurra uji, me sasi deri një vade uje, si: Palucaj, Çokut, Leja, Qepuraj, Gjoshgoraj, Gurrcit dhe Shyuroll.

Kanë arritur të shuajnë kureshtjen e tyre, të bindin veten dhe ne, por mendoj se do të ngacmojmë edhe të tjerët që kjo shpellë është një monument natyror i kulturës që duhet vlerësuar. Mendoj se duhet vlerësuar së pari nga pushteti lokal, pastaj nga specialistët e kësaj fushe, sepse nuk është nevoja që të gjitha bukuritë tona natyrore t'i "zbulojnë" të huajt ...!?

Pas atij udhëtimi të bukur, të lodhshëm, por mjaft mbresëlënës, ekipi padyshim që e meritonte një pushim të veçantë, për këtë adresë dihej ...!? Shkuam në shtëpinë e Pjetër Rrokut, ku na priste bujaria karakteristike e banorëve të Kirit, por edhe një qengj fërlik që i zoti i shtëpisë e kishte pjekur për ne.

Nëpërmjet këtij reportazhi desha të sjell mbresat, emocionet dhe kënaqësinë që ne e përjetuam gjatë këtij udhëtimi, desha që të krijoj tek ju lexues të gazetës "Dukagjini" idenë mbi bukuritë dhe vlerat që mbart kjo shpellë ...

Jam i bindur se në zonën e Dukagjinit ka edhe shumë vlera të tjera turistike, që ne duhet t'i publikojmë, që ne duhet t'i ekspozojmë para turistëve dhe vizitorëve, prandaj ju ftoj që të na shkruani ...

Nga Lulash Brigja



më të trashë edhe pse ishte gushti i verës.

Të nxitur nga kureshtja për të hyrë sa më parë në thellësi të shpellës, por edhe nga mungesa e përvojës për ndërmarrje të tilla të guximshme e morëm pak si të lehte udhëtimin në brendësi të saj.

Vetëm në 100 metrat e para ishte diçka e zakonshme, një lartësi prej 25 metra dhe gjerësi 8-10 metra, pastaj shpella shfaqej me karakteristikat e saj tejet të veçanta. Duhej të ngjiteshe nëpër kacione të ngushta, por edhe të zvarriteshe në vrime shumë të ngushta, që pasoheshin nga hapësira të tjera të gjëra.

Mendoj se e veçanta, që te bënte të insistojë për të ecur më në thellësi të shpellës ishte se nuk kishte degëzime ose xhepa anësore, dhe kjo të siguronte që nuk do humbisje rrugën për

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Drita Shyti, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Florenc Buxha, Lulash Brigja